përmbajtja



Portreti i muajit: Lider, mik dhe hero 2

Avni Avdiu: 20 vjet më parë..............................3-4

Muhamet Jahiri: Sejdiu: Kosova ka ecur shumë brenda një viti 5

Elona Magashi: Fillojnë punën gjyqtarët dhe prokurorët e dekretuar 6-7

Intervistë me Sami Kurteshin 8-9

Intervistë me Refki Morinën 10

Lulzim Ahmeti: Privatizimi i PTK-së hap (jo) i qëlluar...11

Fatos Shala: Të pastrehët kërkojnë strehë! 12

Driton Bublaku: Pas GJND-së do të ketë njohje dhe anëtarësime..13

Qëndresë Mustafa: Pavarësia e Kosovës e pranueshme për GJND-në 14-15

Drita Vitia: Talentët e rinj...........................16-17

Blerta Maliqaj: Fluks i madh studentësh në Universitetin e Prishtinës 18

Isa Mehmeti: Bujrum qostek në xhami...............19

Bukuria që magjeps 20-21

Intervistë me Nora Hysenaj.........................22-24

Jeton Isufi: Kampanja "Ndal diskriminimin"...... 25

Milazim Mustafa: Kundërthëniet në menaxhimin e të drejtave të njeriut 26-27

Astrit Veliqi: Eksponatet – dëshmi të vuajtjes dhe krenarisë 28

Letra e Aliut drejtuar banorëve të Irakut.......29-31

Agim Avdiu: Nili – Burim konfliktesh.................32

Mr. Rexhep Ahmeti: Krizë ideologjike po, krizë idealesh jo! 33

Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli: Puçrrat e rinisë 34

Dr. Abdullah Hamiti: Deformimi i besimeve fetare në letërsi 35-36

Intervistë me balerinin Sinan Kajtazi 37

Imer Topanica: Mbi estetikën e një shfaqjeje 38

Alban Bilalli: Edhe një junikas kampion i boksit në Gjermani 39

Dilaver Polisi: Pas paraqitjes në "Afrika e Jugut 2010" vijnë ofertat për Shaqirin 40









PAQJA



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti V / Nr. 44

19 korrik 2010 - 19 gusht 2010

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI

kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

Avni AVDIU

avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës

Flamur MALOKU

flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

Osman D. GASHI

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

Mimoza SINANI

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Portreti i muajit

Lider, mik dhe hero

Ish-presidenti amerikan Bill Klinton dhe ish-kryeministri britanik Toni Bler janë dy personalitet më meritorë për mbështetjen e Kosovës, në momentet kur ishte më se e nevojshme. Njëmbëdhjetë vjet pas çlirimit të Kosovës, ata vazhdojnë të mbajnë lidhshmëri me vendin tonë. Shqiptarët e Kosovës nuk i shlyejnë dot nga kujtesa fjalimet e tyre të zjarrta dhe me plot vendosmëri kundër regjimit të Milloshevigit, fjalime që i mbollën tmerrin diktatorit serb. Klinton dhe Bler ishin dy faktorët kryesorë në botë që iniciuan intervenimin e NATO-s për çlirimin e Kosovës nga Serbia.

Bler tha se nuk është penduar që ka përkrahur intervenimin e NATO-s në Kosovë për dëbimin e forcave serbe dhe se gjithnjë do të vazhdojë të jetë në anën e Kosovës. Ai, para masës së tubuar, ka folur shkurt: "Ju keni luftuar shumë për të krijuar shtetin e Kosovës. Tani, para jush, shtrihet një betejë tjetër, ajo është beteja e paqes".



Në sheshin kryesor të Prishtinës, njerëzit brohorisnin emrin e tij dhe valëvitnin flamujt britanikë. Organizatorët e vizitës së Toni Blerit në Kosovë i kishin rezervuar atij edhe një befasi, duke vendosur në skenë nëntë fëmijë njëmbëdhjetëvjeçarë, prindërit e të cilëve i kishin pagëzuar ata me emrin Tonibler.

Duke e përshkruar atmosferën, agjencia "AFP" raportoi se Bler, së bashku me nëntë fëmijët që bartin emrin e tij, kënduan këngën e Majkëll Xheksonit, "We are the world", ndërkohë që në prapavijë qëndronte varur një billbord gjigant me fjalët "Lider, mik dhe hero", duke iu referuar Toni Blerit.

Ish-Kryeministri Bler tregoi para qytetarëve të Kosovës edhe disa gjëra personale. Ai tha se gruaja e tij kishte qenë një ndër personat më të afërt, e cila i kishte ndihmuar të bënte atë që ishte dashur të bënte për qytetarët e Kosovës.

Ai foli edhe në Parlamentin e Kosovës. Në një seancë solemne, ai ka kërkuar nga udhëheqësit kosovarë që të vazhdojnë ndërtimin e shtetit.

BIOGRAFIA: **Toni Bler** ka lindur më 6 maj 1953, në Edinburg, në Skoci. Pjesën më të madhe të fëmijërisë e kaloi në Durham, Angli. Ai kreu studimet e drejtësisë në Oksford. Më 1983 u zgjodh anëtar i parlamentit anglez nga Sedgefield. U bë anëtar i Partisë Laburiste më 1994, parti kjo që atë kohë dominohej politikisht nga Partia Konservatore e Margaret Theçerit. Tri vjet më vonë, më 1997, kur kishte 44 vjet, u emërua kryeministër, duke zëvendësuar kryeministrin e atëhershëm Xhon Mejxhor. Kështu, ai u bë kryeministri më i ri britanik i shekullit. Në këtë post qëndroi deri më vitin 2007, pra plot dhjetë vjet.

Toni Bler u nderua me titullin "Doctor Honoris Causa" nga Universiteti i Prishtinës. Po ashtu, u nderua nga Presidenti Fatmir Sejdiu me "Medaljen e Artë të Lirisë", ndërkaq nga Kryeministri Hashim Thaçi mori një kopje të Deklaratës së Pavarësisë. ■

20 vjet më parë

Avni AVDIU

Duke krahasuar rrethanat kohore, Shqipëria dhe Kosova para njëzet vitesh ishin asgjëkund. Para dy dekadash, të dy këto vende, padrejtësisht të ndara ndër shekuj nga fuqitë e atëhershme të mëdha botërore, me shumë troje të shpërndara gjithandej rreth e rrotull kufijve të tyre, kishin nisur rrugëtimin historik për ta kthyer së mbari rrotën e kohës. Por akrepat e orës shqiptare shkonin shumë ngadalshëm. Çdo sekondë, minutë, orë... përshkohej me ngjarje rrëqethëse. Andej kufirit lot, vaj, plagë, viktima. Ngjashëm edhe këtej kufirit. Ishin dhimbje shtatzënie, sepse në dritë pritej të dilte LIRIA, aq shumë e dëshiruar dhe aq shumë e munguar. Embrioni tashmë ishte zhvilluar përmes shumë peripecish dhe të gjithë prisnin... prisnin që ai të mos dalë me të qara, por me buzëqeshje.

Shqipëria po këpuste me shumë mund prangat e robërisë komuniste, që e kishte shndërruar vendin në bunker të izoluar nga e tërë bota. Komunizmi nuk kishte bunkerizuar vetëm tokën shqiptare, por edhe mendjet, duke mbjellë propagandë të pistë se vendi po lulëzonte, ndërsa bota perëndimore po vdiste nga uria. Izolimi dhe armiqësia me gjithë botën, ishte gjëja më e keqe antikombëtare që mund të imagjinohej, sepse për Shqipërinë shkaktonte mjerim e varfëri të skajshme, kurse për Kosovën mungesë të përkrahjes ndërkombëtare. Dhe kështu vazhdoi gati pesë dekada.

Mirëpo, erdhi momenti që diktatura e hekurt të binte si një kullë prej letre. Shqiptarët të mllefosur tej mase nga regjimi vërshuan rrugëve, duke manifestuar pakënaqësinë e madhe ndaj pushtetit. Në sy të opinionit vendas dhe të huaj, i ashtuquajturi "pushtet popullor" mori turpërimin më të madh të parë ndonjëherë, goditjen më të rëndë. Bisha e plagosur për ngordhje po i jepte shqelmat e fundit. Pushteti i vendosur më 1944, jo përmes zgjedhjeve, por nëpërmjet dhunës dhe forcës së armëve, filloi t'i kërcëllinte dhëmbët për të fundit herë. Përpara syve shihte tmerrin e humbjes së pushtetit, gjersa nën këmbë i dridhej toka. Hyrja nëpër dyert e ambasadave, ishte një simbolikë në vete. Më 2 korrik 1990, pati një intensifikim të hyrjes me dhunë në disa ambasadave të akredituara në Shqipëri, në atë italiane, në ambasadën e Republikës Federale Gjermane, në atë greke, polake, çeke, etj. Ky depërtim i papritur i tregonte regjimit se Shqipëria nuk mund të ishte ndryshe, jashtë zhvillimeve në lindje të Evropës. Falë atyre zhvillimeve, sot Shqipëria është vendi i zgjedhjeve të lira, i shtetit ligjor, i të drejtave të njeriut, i prosperitetit ekonomik dhe me shpresë dhe besim të madh tek e ardhmja.

Në anën tjetër, Kosova përjetonte gjithashtu momentet më dramatike. Dhuna sistematike serbe kishte arritur kulmin. Autonomia e fituar që nga Jugosllavia titiste më 1974, që garantonte diç më shumë të drejta për shqiptarët, u suprimua me forcën e tankeve. Të vetëdijshëm për momentin historik para të cilit ndodheshin, delegatët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës, më 2 korrik të vitit 1990, miratuan para parlamentit (me dyer të mbyllura) Deklaratën Kushtetuese, me të cilën Kosova u shpall njësi e veçantë në kuadër të federatës së atëhershme jugosllave.

Dy muaj pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese, që ndryshe njihet edhe si Deklarata e Pavarësisë, pra më 7 shtator të vitit 1990, të njëjtët delegatë nxorën aktin më të lartë juridik - Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke e shpallur edhe formalisht Kosovën Republikë.

Serbia u kundërpërgjigj me mbylljen e institucioneve arsimore, me mbylljen e mediave, me dëbimin e shqiptarëve nga puna, me helmimin e nxënësve dhe me masa të tjera drakonike të padurueshme.

Ishte kjo koha kur filloi shpërbërja e krijesës artificiale të quajtur Jugosllavi, nën tensionet dhe kërcënimet serbe për gjithë popujt rreth e përqark.

Historikisht, 2 korriku i vitit 1990 shënon për shqiptarët e Kosovës gurthemelin e pavarësisë së formalizuar më 17 shkurt 2008. Atëherë ishte pikënisja e një të ardhme, që në atë kohë dukej e vagullt.

Sot Kosova është në procesin e njohjeve ndërkombëtare të shtetësisë dhe në rrugë të mbarë drejt integrimeve evropiane. Brenda njëzet vitesh janë bërë ndryshime të mëdha dhe nëse kujtojmë 2 korrikun e vitit 1990, si për Shqipërinë, ashtu edhe për Kosovën, atëherë duhet pranuar se gjërat kanë shkuar nga e mbara e përgjithshme. Zaten, tashmë, Shqipëria dhe Kosova edhe gjeografikisht janë më pranë njëra-tjetrës, falë aksit të ri rrugor që ende është në procesin e ndërtimit (në anën e Kosovës).

Mirëpo fakti se ku kemi qenë njëzet vjet më parë e ku jemi tani, nuk duhet të jetë ndonjë satisfaksion i madh, kur kihet parasysh fakti se ka mundur të bëhej më tepër në të gjitha drejtimet dhe se na presin akoma punë të shumta. ■

Kufiri Shqipëri – Kosovë


Shqipëri







Vërshimi në ambasadat e huaja në Tiranë



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE
HETUESIA E PËRGJITHSHME
Nr. 699 Prot.

Tepër Sekret
Ekzemplar Nr. 3
Tiranë, më 3.7.1990

LENDA: Per ngjarjen e ndodhur ne teritorin e ambasadave.

MINISTRIT TË PUNËVE TË BRËNDSHME
SHOKUT SIMON STEFANI
TIRANE

Ne daten 2.7.1990, pati nje intensifikin te hyrjes me dhune ne teritorin e disa ambasadave te akredituara ne vendin tone. Ne oren 10.30 hyjne 6 persona ne ambasaden Italiane me nje makine tip tater, duke shqyer murin rrethues, kangjellat. Ne oren 19.00,

vjedhje, grabitje e vrasje etj. Edhe personat e grumbulluar prane teritorit te ambasadave jane te njohur ne pergjithesi per sjellje rrugaçerie e te denuar me pare.

Po hetohet per te zbuluar organizatoret e kesaj veprimtarie armiqesore, personat qe kane marre pjese dhe demet qe i jane shkaktuar pasurise socialiste. Per kete qellim eshte organizaur bashkepunimi me Ministrine e Puneve te Brendshme, Ministrin e Drejtesise, Prokurorin e Pergjithshem dhe kryetarin e Gjykates se Larte.

KRYETARI I HETUESISE SE PERGJITHSHME
QEMAL LAME

2 KORRIK 1990



Bujar Gjurgjeala lexon Deklaraten Kushtetuese




Hashim Thaçi - Deklarata e Pavarësisë



Kështu ishte atë ditë në Prishtinën heroike pas leximit të Aktit Kushtetues

Kosovë



Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka mbajtur fjalimin e tij vjetor para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Sejdiu: Kosova ka ecur shumë brenda një viti

Muhamet JAHIRI

Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka mbajtur fjalimin e tij vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, me ç'rast ka folur për arritjet dhe sukseset e Kosovës brenda një viti.

Presidenti Sejdiu në fillim të fjalimit ka thënë se Republika e Kosovës ka arritur shumë shpejt që t'i vendos themelet e saj të shtetndërtimit.

"Republika e Kosovës, gjatë këtyre dy viteve e gjysmë të pavarësimit të saj, ka arritur të bëjë hapa vendimtarë për t'i ndërtuar institucionet e saj demokratike; ka arritur të ketë Kushtetutën dhe Ligjet, Gjykatën Kushtetuese, Agjencinë e Inteligjencës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe të gjitha i ka bërë në përputhshmëri të plotë me Pakon e Ahtisarit, duke garantuar plotësisht të drejtat e komuniteteve pakicë", - ka thënë presidenti Sejdiu.

"Ftoj zyrtarët e Beogradit, edhe presidentin Tadiç, të distancohet nga grupet e tilla, që nxiten dhe përkrahen për të shkaktuar tensione dhe dhunë. Fryma e nxitjes doli në pah edhe pas incidentit të fundit në Mitrovicë, në të cilin pësoi një qytetar i komunitetit boshnjak, ndërsa dhjetë të tjerë, pjesëtarë të komunitetit serb, u plagosën", - është shprehur i pari i vendit, duke shtuar se nga Beogradi erdhi edhe sulmi ndaj deputeti Millitiç.

Po ashtu, Presidenti Sejdiu ka kërkuar nga deputetët dhe institucionet që të punohet më shumë në luftimin e krimit dhe korrupsionit, të forcohet ekonomia, ndërkohë që nga Komisioni Evropian kërkoi përkrahje që edhe Kosova të përfshihet në procesin e liberalizimit të vizave.

"Me fqinjët tanë të parë, Maqedoninë, Shqipërinë dhe Malin e Zi, ne tashmë kemi ndërtuar raporte të shkëlqyeshme, të cilat po zhvillohen në mënyrë konkrete, çdo ditë e më shumë. Pata nderin që, gjatë muajit qershor të këtij viti, të jem nikoqir i Samitit të Tretë të liderëve të rajonit, i cili u mbajt në një ndër vendet me të bukura të Kosovës, në Prevallë të Prizrenit. Sikurse edhe dy takimet e para, të mbajtura në Vlorë dhe në Ohër, edhe takimi i mbajtur në Prizren dëshmoi gatishmërinë tonë të përbashkët që të gjejmë mënyra praktike për ta lehtësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve, si bazë e rëndësishme për proceset integruese", - ka thënë presidenti Sejdiu në fjalimin vjetor të tij.

Sipas Presidenti Sejdiu, ekonomia mbetet sfida kryesore e shtetit të ri të Kosovës, sepse ajo është parakusht për të gjitha zhvillimet e tjera në vend.

"Ne jemi kalimtarë, i përhershëm është vetëm interesi i qytetarit, është atdheu ynë", - është shprehur presidenti Sejdiu në fund të fjalimit të tij, duke bekuar Republikën e Kosovës dhe miqtë e saj.

LDD e AAK bojkotojnë seancën

Në anën tjetër, deputetët e opozitës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDD) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e kanë bojkotuar seancën, në kohën kur atyre po u drejtohej presidenti i vendit Fatmir Sejdiu. Ata e arsyetuan këtë me faktin se, sipas tyre, presidenti Sejdiu është shkelësi më i madh i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), nëpërmjet Lulzim Zenelit, e ka akuzuar presidentin Sejdiu si shkelës të Kushtetutës me mbajtjen e dy posteve.

Gjini: Presidenti Sejdiu po e shkel Kushtetutën

Edhe shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, ka thënë se deputetët kanë vepruar mirë kur kanë lëshuar sallën.

"Me plot të drejtë, një pjesë e mirë e deputetëve mendojnë se presidenti i Kosovës po e shkel Kushtetutën. Për atë arsye, duhet t'i tregohet se ka revoltë politike të deputetëve, që t'i tregohet se nëse do ta respektojë Kuvendin, e meriton respektin e Kuvendit; nëse është e kundërta, nuk e meriton", - ka deklaruar Gjini.

Rrustemi: I dhamë mesazh Sejdiut se nuk e pasqyron unitetin e popullit

Ngjashëm me Gjinin, edhe iniciuesi i shqyrtimit të dy posteve të presidentit në Gjykatën Kushtetuese, Naim Rrustemi, ka thënë se deputetët vetëm i dhanë një mesazh Sejdiut se, me mbajtjen e postit të kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ai nuk përfaqëson edhe unitetin e popullit të Kosovës. ■

Gjyqtarët dhe prokurorët e dekretuar nga Presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu kanë filluar punën

Fillojnë punën gjyqtarët d

"E dimë se gjykatat në Kosovë kanë probleme të shumta, mirëpo sa i përket Gjykatës së Qarkut në Prishtinë unë do mundohem që të gjitha problemet që i hasim gjatë punës t'i zgjidhim së bashku me gjyqtarët, prokurorët dhe stafin tjetër në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe korrekte", - ka deklaruar kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Isak Ademi.

Elona MAGASHI

Gjyqtarët dhe prokurorët e riemëruar që profesionin e tyre ta ushtrojnë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë tashmë kanë filluar punën. Disa ditë pas dekretimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu, ata kanë filluar të akomodohen në punën e tyre, sikurse edhe kolegët që e kanë kryer këtë funksion vite me radhë në këtë gjykatë.

Përveç tyre, Gjykata e Qarkut në Prishtinë është bërë edhe me kryetar të ri. Isak Ademi, i pari i kësaj gjykate, ka thënë për revistën "Paqja" se është i gatshëm ta udhëheqë mirë detyrën e tij të re.

Gjyqtarët dhe prokurorët e dekretuar

Gjykata Supreme e Kosovës: Gjyqtare Vjosa Nimani - Zylfiu dhe Marije Ademi
Prokuroria e Shtetit të Republikës së Kosovës: Prokurore Laura Pula
Paneli Gjykues i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme: Gjyqtarë: Ilmi Bajrami dhe Sabri Halili
Paneli ankues i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme: Gjyqtar Sahit Sylejmani.
Gjykata e Qarkut në Prishtinë: Kryetar Isak Ademi, gjyqtarë: Tonka Berishaj, Salih Topolica, Ramadan Gudaqi, Shemsi Hajdini, Mediha Jusufi, Vehbi Kashtanjeva, Gëzim Llulluni, Mejreme Memaj, Shqipe Qerimi, Mejdi Dehari, Fëllanza Kadiu, Hamdi Ibrahimi, Hajrije Shala dhe Nehat Idrizi
Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë: Kryeprokuror Aleksandër Lumezi, prokurorë: Haxhi Dërguti, Drita Hajdari – Peci, Blerim Isufaj, Fikrije Krasniqi- Fejzullahu, Lulzim Sylejmani
Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë: Gjyqtarë: Vjollca Rizaj, Suzana Sejdiu, Nezir Bytyqi
Gjykata e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë: Kryetare Biljana Rexhiqi, gjyqtarë: Dalip Bega, Kamiz Kuçi, Ragip Nimani, Mejreme Zekaj
Gjykata e Qarkut Prizren: Kryetar Ymer Hoxha, gjyqtarë: Xhevdet Elshani, Erdogan Haxhibeqiri, Kujtim Pasuli, Edije Sezairi, Ajser Skenderi, Fillim Skoro.
Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren: Kryeprokuror Rexhep Rexhepaj, prokurorë: Metush Biraj, Ervehe Gashi, Sylë Hoxha, Genc Nixha, Mehdi Sefa
Gjykata e Qarkut Pejë: Kryetar Sali Berisha, gjyqtarë: Isa Kelmendi, Gëzim Pozhegu, Hasan Shala, Muharrem Shala, Shaban Shala, Elmaze Syka, Imer Jahmurataj, Lumturie Muhaxheri
Prokuroria Publike e Qarkut në Pejë: Kryeprokuror Agron Galani, prokurorë: Agim Kurmehaj, Gjemajlije Mustafa, Haxhi Sinanaj, Ali Uka
Gjykata e Qarkut në Gjilan: Gjyqtarë: Abdullah Ahmeti, Vllastimir Dimiç, Zyhdi Haziri, Rasim Rasimi, Muhamet Rexha dhe Ilmi Dalipi
Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan: Kryeprokuror Jetish Maloku, prokurorë: Fahri Nuhiu, Shaban Spahiu, Agron Uka, Ismet Ukshini.



"Jam i gatshëm që pozicionin tim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ta udhëheq në mënyrë sa më korrekte", - ka thënë ai.

Ademi, madje, ka shtuar se të gjitha problemet e kësaj gjykate ai do t'i zgjidhë së bashku me kolegët e tij.

"E dimë se gjykatat në Kosovë kanë probleme të shumta, mirëpo sa i përket Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, unë do mundohem që të gjitha problemet që i hasim gjatë punës t'i zgjidhim së bashku me gjyqtarët, prokurorët dhe stafin tjetër në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe korrekte", - ka thënë Ademi.

Sejdiu: Gjyqtarët dhe prokurorët të jenë të paanshëm

Presidenti i Republikës së Kosovës ka thënë se puna e gjyqtarëve dhe prokurorëve është barrë e rëndë dhe fisnike. Ai, në ditën e dekretimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka kërkuar nga ta të jenë profesionalë, të ndershëm dhe të paanshëm karshi politikës.

"Ajo që kërkohet prej jush është profesionalizimi, ndershmëria dhe paanshmëria politike për një punë të suksesshme, duke iu përqendruar sfidave që keni para vetes", - ka thënë presidenti Sejdiu, gjatë dekretimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës.

Po në këtë kontekst, i pari i vendit ka thek-

he prokurorët e dekretuar



suar se gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit kanë borxh të kenë mandat të gjatë kohor për punë të suksesshme.

"Meqë jam njeri i politikës mund të them se elitat politike mund të vinë dhe të shkojnë, është çështje e proceseve zgjedhore, ndërsa gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit kanë për borxh, sikurse edhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës, të kenë mandat të gjatë kohor për punë të suksesshme", - ka deklaruar Sejdiu.

Peci: Riemërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve do të ndikojë në zbutjen e lëndëve

Ndërsa kryesuesi i KGJK-së, Enver Peci ka thënë se sistemi gjyqësor i Kosovës është në reformën më të thellë të tij dhe, sipas tij, riemërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve do të ndikojë në zbutjen e lëndëve nëpër gjykatat e Kosovës.

"Sistemi gjyqësor është në reformën më të thellë të tij, ndërsa riemërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve do të ndikojë në zbutjen e lëndëve nëpër gjykatat e Kosovës", - është shprehur Peci.

Ai ka treguar se pjesa dërmuese e lëndëve të pazgjidhura janë në gjykatat Komunale të Kosovës dhe, sipas tij, në mesin e këtyre lëndëve hynë edhe ato të ekzekutimeve.

"Sipas statistikave që ne posedojmë janë 100 mijë raste të lëndëve të ekzekutimeve", - ka deklaruar ai.

Peci ka thënë se gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës kanë nevojë edhe për më shumë punonjës të ligjit dhe, sipas tij, procesi i riemërimit ka lënë edhe vende bosh në disa gjykata.

"Nuk është plotësuar numri i gjithë gjyqtarëve në disa gjykata, andaj mund të them se mungon një ose dy gjyqtarë, ndërsa për Gjykatën e Qarkut në Gjilan nuk është riemëruar kryetari i saj, sepse nuk kemi pas kandidatët që kemi menduar se i plotësojnë kushtet për atë pozicion", - ka theksuar ai.

Peci ka paralajmëruar se ka filluar edhe intervistimi i kandidatëve për fazën e tretë të riemërimit.

"Për fazën e tretë ne jemi në proces të intervistimit të kandidatëve dhe kemi përfunduar me regjionin e Prishtinës, ndërsa kemi filluar intervistimin edhe në regjionin e Prizrenit. Deri më 14 shtator mendojmë ta përfundojmë fazën e intervistimit dhe, më pas, vazhdon procedura e propozimeve dhe e rekomandimeve prej Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, si dhe në fund dekretimi nga ana e presidentit", - ka deklaruar Peci.



Intervistë me Avokatin e Popullit të Kosovës, Sami Kurteshi

Kurteshi: Qytetarët drejtojnë më së sh

Intervistoi: Qëndresë MUSTAFA

Prishtinë – Është njëri nga personat e ligjit që kërkon nga qytetarët e Kosovës të kenë besim në institucionin që ai udhëheq, pasi që premton se puna e tyre është e paanshme, e pavarur dhe në interes të qytetarëve.

Edhe përkundër sfidave me të cilat ballafaqohet, thotë se do të luftojë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, që sipas tij është në gjendje jo të mirë.

"Shteti ka për detyrë garantimin, mbrojtjen, parandalimin e shkeljeve, si dhe përmirësimin e përhershëm të gjendjes së të drejtave të njeriut", - thotë ai.

Tregon se në institucionin që ai drejton më së shumti ankesa drejtohen kundër gjyqësorit të Kosovës. Ai, madje, sistemin e drejtësisë e quan si segmentin më të brishtë shoqëror dhe shtetëror. Mendon se gjyqësori i Kosovës e ka marrë këtë epitet pasi që nuk trajtohet si një ndër tri pushtetet e barabarta në Republikën e Kosovës.

Në fund, u bën thirrje të gjithë qytetarëve të Kosovës të lajmërohen dhe të bashkëpunojnë me institucionin që ai drejton, sepse, sipas tij, vetëm kjo mund të ndikojë në përmirësimin e institucioneve shtetërore.

Për më shumë flet për Revistën "Paqja", Avokati i Popullit, Sami Kurteshi.

PAQJA: ***Z. Kurteshi, cila është gjendja momentale e institucionit që ju udhëhiqni? A kini probleme apo sfida para vetes?***

Kurteshi: Natyrisht, si çdo institucion tjetër në Kosovë edhe ne kemi probleme. Sfidat tona kryesore janë miratimi i ligjit për institucionin e Avokatit të Popullit, sigurimi i hapësirave të tjera të mjaftueshme për punë, plotësimi i vendeve në institucion me njerëz të mjaftueshëm, largimi i tepricave dhe sigurimi i kualitetit profesional.

PAQJA: ***Z. Kurteshi nëse vërtet ky institucion ka hasur në probleme, cila është strategjia juaj për tejkalimin e tyre?***

Kurteshi: Mund të them se strategjia ime për tejkalimin e problemeve dhe sfidave në këtë institucion është puna, që do të thotë të ketë vetëm punë kualitative, bashkëpunimi i mirë me të gjithë partnerët, komunikimi i drejtë dhe përpjekjet për përmirësime të përhershme.

PAQJA: ***Z. Kurteshi, që nga marrja e detyrës si Avokat i Popullit, çka ka ndryshuar ky institucion?***

Kurteshi: Nëse mund të quhet ndryshim i madh, atëherë ky ndryshim ka të bëjë me mënyrën e punës. Por ka shumë ndryshime të vogla, objektive. Ndryshimi kryesor është se po bëjmë operacionalizimin e normave kushtetuese me veprimet konkrete. Po ashtu, po i kushtojmë një rëndësi të veçantë specializimit të bashkëpunëtorëve.

PAQJA: ***Z. Kurteshi sa ankesa janë momentalisht në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe sa prej tyre kanë përfunduar?***

Kurteshi: Në Institucionin e Avokati të Popullit, gjatë periudhës 1 korrik 2008 e deri më 30 qershor 2009, janë pranuar 1mijë e 31 ankesa, në mesin e të cilave janë zgjidhur pozitivisht 137 sosh. Ndërsa në periudhën 1 janar 2009 e deri më 31 dhjetor 2009, janë pranuar 1 mijë e 318 ankesa të ndryshme, prej tyre të zgjidhura pozitivisht 127 sosh.

PAQJA: ***Ka shumë njerëz në Kosovë që i kanë adresuar hallet e tyre në këtë institucion. Z. Kurteshi, a mund të na thoni se të cilës natyrë u drejtohen më së shumti ankesa nga qytetarët e vendit?***

Kurteshi: Institucioni i Avokatit të Popullit ballafaqohet me shumë ankesa. Në radhë të parë, janë ankesat kundër gjyqësorit që arrijnë deri në 30 për qind, pastaj për ministritë me 26 për qind, për komunat me 22 për qind, për policinë me 5 për qind, për Agjencionin Kosovar për Pronësi (AKP) me 4 për qind dhe për të tjera, diku rreth 15%, që përfshijnë institucione publike nga më të ndryshmet.

PAQJA: ***Z. Kurteshi, cila është gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë?***

Kurteshi: Personalisht them se është një gjendje jo e mirë. Ka shkelje të ndryshme dhe të shumta. Tendencë të organizuar shtetërore për

umti ankesa për gjyqësorin e Kosovës

shkelje të drejtave të njeriut nuk ka. Por kjo nuk mjafton për një shoqëri. Shteti ka për detyrë garantimin, mbrojtjen, parandalimin e shkeljeve, si dhe përmirësimin e përhershëm të gjendjes së të drejtave të njeriut.

PAQJA: ***Z. Kurteshi si e vlerësoni gjyqësinë në Kosovë, kur dihet se është një ndër fushat më të ndjeshme dhe më të kritikuara?***

Kurteshi: Gjyqësori është në gjendjen më të keqe dhe segmenti më i brishtë shoqëror dhe shtetëror. Jo krejt me fajin e vet, por kryesisht po. Nuk është trajtuar dhe as nuk trajtohet si një ndër tri pushtetet e barabarta në Republikën e Kosovës. Gjyqësori kosovar duhet të shikojë nëse dy pushtetet e tjera kanë mëshirë dhe vullnet e dëshirë t'i japin diçka a jo. Këtu nuk kemi tri pushtete të barabarta, ashtu si thotë Kushtetuta, prandaj ky është defekti kryesor. Defekti tjetër është trashëgimia e filozofisë dhe kulturës burokratike, krejtësisht të varur dhe parazite. Pastaj, kemi raste të korrupsionit dhe të padrejtësive në vetë gjyqësorin. Ky institucion duhet të reformohet dhe të vijnë njerëz të rinj, me edukatë dhe përgatitje dhe që nuk kanë asnjë njollë sa i përket ndarjes së drejtësisë, që nuk kanë marrë kurrë vendime nën presionin e të tjerëve dhe që nuk kanë shkelur vetë të drejtat e njeriut me vendime të tilla. E kjo do kohë. Por ajo që është më shqetësuese është humbja e besimit të njerëzve, të qytetarëve në drejtësinë institucionale dhe shoqërore.

PAQJA: ***Z. Kurteshi, a funksionojnë qendrat e Avokatit të Popullit edhe nëpër komuna?***

Kurteshi: Të gjitha zyrat tona regjionale në Prizren, Gjilan, Pejë, në Mitrovicë (dy) dhe në Graçanicë, funksionojnë rregullisht dhe me kapacitet të plotë.

PAQJA: ***Z. Kurteshi, a jeni duke shikuar mundësinë e zgjerimit të këtyre qendrave edhe nëpër komunat e tjera?***

Kurteshi: Gjithsesi, nëse gjejmë mjete dhe donatorë. Kërkesën e kemi paraqitur, që disa muaj, tek institucionet tona dhe tek partnerët ndërkombëtarë. Po presim përgjigjet e tyre.

PAQJA: ***Z. Kurteshi, a do të vazhdoni me ditën e hapur (open day) për t'i takuar qytetarët?***

Kurteshi: Kjo nuk është ndalur kurrë dhe nuk do ta ndërpresim këtë praktikë. Madje mendojmë ta zgjerojmë edhe më, me ardhjen e zëvendësve të tjerë.

PAQJA: ***Z. Kurteshi, cili është mesazhi juaj për qytetarët e Kosovës, e në veçanti për minoritetet?***



Kurteshi: Mesazhi për të gjithë qytetarët, pa ndonjë dallim, është të lajmërohen dhe të bashkëpunojnë me Institucionin e Avokatit të Popullit, nëse dëshirojnë të ndikojnë në përmirësimin e institucioneve shtetërore. Si çdo qytetar i Republikës së Kosovës edhe komunitet pakicë janë në atdheun e tyre. Kosovën, vetëm së bashku, mund ta bëjmë të mirë dhe të krenohemi të gjithë me të.

PAQJA: ***Z. Kurteshi, pse qytetarët duhet t'iu besojnë juve dhe pse duhet t'i shfaqin problemet e tyre në këtë institucion?***

Kurteshi: Qytetarët e Kosovës duhet të besojnë dhe duhet të drejtohen te ne sepse Institucioni i Avokatit të Popullit është i paanshëm, i pavarur dhe sepse ne jemi të bindur për të drejtat e njeriut, e duam vendin tonë, merremi seriozisht me qytetarin, me individin dhe luftojmë për ta së bashku me ta. ■

Intervistë me Refki Morinën

Kosovën për gjashtë muaj e vizitojnë 266 shtetas të huaj

Intervistoi: Alban ZENELI

Që nga fillimi i këtij viti Kosovën e kanë vizituar 266 shtetas të huaj që janë regjistruar në Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj në Kuadër të Policisë së Kosovës. Drejtori i këtij departamenti thotë se qytetarët e huaj që hyjnë në vend duhet të paraqesin vetëm dokumentet valide nga shteti ku vijnë së bashku me arsyet e vizitës pasi që Kosova nuk ka regjim të vizave ndaj ndonjë vendi. Sipas tij edhe qytetarët e Kosovës që janë duke i strehuar shtetasit e huaj obligohen që këtë gjë ta paraqesin te policia pasi që në të kundërtën mund të ndiqen nga gjykata për kundërvajtje. Morina tregon se edhe në vendin tonë ka kërkesa për azil nga shtetas të huaj, sipas tij në gjashtë muajt e parë të këtij viti ka pasur 15 kërkesa nga azilkërkues të vendeve të ndryshme. Flet për revistën "Paqja", drejtori i Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, Refki Morina.

PAQJA: ***Çfarë pune kryen Drejtoria për Migrim dhe të Huaj e Policisë së Kosovës?***

Morina: Funksionojmë prej vitit 2005 si Zyrë për Migrim, pastaj gradualisht jemi transformuar në Drejtori për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Policisë Kufitare të Kosovës. Ne si drejtori e mbulojmë tërë territorin e Kosovës, në Polici Kufitare i kemi tri rajone, në të cilat i kemi edhe zyrat për migrim nga dy policë në secilën zyrë.

PAQJA: ***Kush mund të hyjë në Kosovë?***

Morina: Kosova është e hapur për të gjithë shtetasit që dëshirojnë të hyjnë sepse nuk kemi regjim të vizave. Nëse një i huaj hyn në aeroport ose në pikat kufitare të Kosovës, vula e cila i jepet pasaportës së tij është valide për 90 ditë qëndrimi. Nëse dëshiron që të kaloj më shumë kohë sesa 90 ditë, atëherë 10 ditë para se të kaloj ky afat duhet të lajmërohet në zyrat tona dhe të praqes dokumentet se në çfarë cilësie dëshiron të qëndrojë në Kosovë dhe njëkohësisht të bëjë një kërkesë për letërnjoftim të përkohshëm.

PAQJA: ***Çfarë të dhëna duhet të paraqes një shtetas i huaj gjatë qëndrimit në vendin tonë?***

Morina: Në qoftë se vijnë për vizitë, duhet të dihet se ku rrinë, hotelin ku vendosen. Kjo është jo vetëm për çështje të sigurisë së shtetit tonë, por edhe për çështje të sigurisë së tyre, në mënyrë që policia përafërsisht të dijë se ku janë vendosur ata persona, që në rast nevoje t'i sigurohet liria e lëvizjes sikurse çdo qytetari tjetër në Kosovë



Refki Morina - drejtor për Migrim dhe të Huaj në PK

PAQJA: ***Çfarë ndodhë në rast se qytetarët e huaj nuk lajmërohen pas afatit 90 ditësh të qëndrimit?***

Morina: Pas skadimit të 90 ditëshit të qëndrimit në Kosovë secili qytetar që nuk lajmërohet për të marrë letërnjoftim të përkohshëm, merret që qëndron ilegalisht dhe ne i procedojmë në gjykatën për kundërvajtje. Numri i rasteve që i kemi dërguar në gjykatë për kundërvajtje është 256 raste, duke përfshirë edhe qytetarët me shtetësi të Kosovës, të cilët nuk kanë lajmëruar për qëndrimin e të huajave, ndërsa sa i përket shtetasve të huaj për procedim në gjykatë prijnë Shqipëria dhe Maqedonia me nga 51 raste.

PAQJA: ***Sa persona kanë hyrë këtë vit në Kosovë?***

Morina: Në këtë drejtori që nga janari i këtij viti kemi pasur gjithsej 266 kërkesa nga persona nga shtete të ndryshme që të hyjnë në Kosovë, numri më i madh i kërkesave ka ardhur nga shtetasit turq, të cilët kanë bërë 94 kërkesa të tilla.

PAQJA: ***Sa persona janë depërtuar?***

Morina: Gjatë këtij gjashtë mujori kemi pasur 93 raste me depërtim ose dëbim nga Kosova me vendim të Gjykatës, ndërsa shtetasit që janë më të shumtë në numër për sa i përket depërtimit janë ata të Shqipërisë gjithsej 55 raste.

PAQJA: ***Një shtetas i huaj si duhet të kërkoj azil në Kosovë?***

Morina: Personat e huaj që vijnë në pikat kufitare kanë të drejtë të kërkojnë azil në Kosovë edhe pranë drejtorisë sonë dhe që nga lajmërimi në polici ne rastin e dërgojmë në Departamentin për Shtetësi dhe Azil që funksionin në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe pastaj ky departament ndjek procedurat e nevojshme për shtetësi dhe azil. Sipas statistikave që kemi ne kemi pasur 15 raste të kërkimit të azilit në Kosovë, ndërsa numri më i madh i azilkërkuesve ka qenë nga Palestina gjithsej gjashtë raste. ■



PRIVATIZIMI I PTK-SË HAP (JO) I QËLLUAR

Lulzim AHMETI

Praktika e privatizimit të ndërmarrjeve publike, që janë në pronësi të Qeverisë së Kosovës, nuk është mirëpritur. Për shumë pak kohë, qeveria nuk do të ketë asnjë ndërmarrje në pronësi të saj. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) i është dhënë me koncesion për 20 vite një konzorciumi farancezo - turk, ndërsa distribucioni i rrjetit dhe shpërndarjes së Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) do të privatizohet deri në fund të vitit. Një fat i tillë do ta gjejë, deri në fund të vitit, edhe Postë Telekomin e Kosovës (PTK). Pasi që PTK-ja, si ndërmarrje publike, është kompania më fitimprurëse në vend dhe gjeneron të hyra për buxhetin e shtetit, privatizimi i saj është konsideruar si hap jo i qëlluar nga ekspertët e ekonomisë dhe nga opozita. Qeveria e Kosovës ka vendosur të mbajë në pronësi të veten vetëm 25 për qind të aseteve të PTK-së. Privatizimi i PTK-së në këtë kohë është kritikuar nga sindikata e PTK-së dhe nga opozita, por ka pas zëra edhe nga ekspertë të ekonomisë që kanë thënë se nuk duhet të privatizohet PTK-ja në këtë kohë. Privatizimi i kompanisë më fitimprurëse në vend është kundërshtuar edhe për shkak të frikës sepse PTK-së do t'i bie vlera në këtë kohë dhe nuk do të mund të tërhiqen investitorët seriozë e të fuqishëm, për shkak të efekteve dhe dobësimit të kompanive nga kriza globale financiare, e cila nuk ka kaluar tërësisht. Po ashtu, është kundërshtuar edhe për shkak të fitimeve që gjeneron për buxhetin e shtetit, si dhe të hyrat që sjell në formë të dividentës. Hapi i qeverisë për të privatizuar 75 për qind të aksioneve të PTK-së është cilësuar dhe kundërshtuar për shkak se nuk do të ketë më të hyra për qeverinë dhe buxhetin e saj, në krahasim me të qenët e qeverisë pronare në tërësi. Po ashtu, me privatizimin e kompanisë, numri i punëtorëve mund të ulet për shkak se në PTK ka pasur punësime të mëdha, që shumë herë është thënë se janë bërë mbi baza partiake dhe klanore. Praktikat e privatizimit të kompanive publike në rajon, por edhe në vend, kanë treguar se çdo herë kur është privatizuar ndonjë ndërmarrje, numri i punëtorëve është ulur në atë kompani, për shkak se pronari i ri e ka ulur numrin e të punësuarve për të ulur edhe shpenzimet. Krejt procesi i privatizimit, që nga fillimi i tij më 2004, ka treguar trende negative për të punësuarit. Shumë pak ndërmarrje janë treguar si të suksesshme në periudhën pas privatizimit. Llogaritet se, për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve dhe ndërrimit të tyre nga ndërmarrje prodhuese në depo, 75 mijë veta kanë mbetur pa punë. Qeveria po e privatizon PTK-në ende pa e ditur vlerën e saj, edhe pse tash Vala dhe Telekomi nuk e kanë vlerën e dikurshme, për shkak se Vala nuk ka monopol në vend, ka konkurrent operatorin privat mobil IPKO, si dhe po i bën konkurrencë të drejtpërdrejtë operatori virtual Z Mobile, i cili ofron çmime më të lira se Vala, duke përdorur infrastrukturën e saj. Zërat kritikë, kur them këtë mendoj për opozitën dhe shoqërinë civile, kanë thënë se privatizimi i 75 për qind të aksioneve të Valës dhe Telekomit do të jetë fundi i kësaj kompanie shumë fitimprurëse. Ndryshe, Postë Telekomi i Kosovës, për shkak të gjenerimit të fitimeve tepër të mëdha që ka pasur, për dy vite i ka dhënë Qeverisë së Kosovës, në formë të dividentës, 280 milionë euro, duke mos harruar edhe financimin dhe sponsorizimin e shumë projekteve sociale, kulturore dhe të sferave të tjera të rëndësishme për shoqërinë kosovare. PTK-ja, gjatë këtij viti, ka kontribuar në buxhetin e Kosovës me 335 milionë euro.

Posta mbetet e shtetit

Edhe pse Telekomi dhe operatori mobil Vala do të privatizohen dhe qeveria do të ketë aksione vetëm 25 për qind, posta do të mbetet e Kosovës edhe pse kjo pjesë e PTK-së nuk gjeneron shumë të hyra për buxhetin, sikurse në të gjitha vendet e botës. Menaxhmenti i PTK-së ka investuar për privatizim 600 mijë euro në dy projekte, ka blerë vetura dhe motoçikleta për të qenë posta më efikase dhe më e shpejtë pas privatizimit, si dhe ka lidhur bashkëpunime të shumta me Postën e Shqipërisë dhe asaj të Maqedonisë.

Praktikat në rajon

Qeveria e Maqedonisë ka rreth 38 për qind të aksioneve në Telekomin e saj, edhe pse ai është privatizuar. Vitin e kaluar, aksionarëve iu nda fitimi prej 100 milionë eurove, prej të cilëve qeveria mori 34 milionë euro, ndërkaq, këtë vit, Qeveria e Maqedonisë do të marrë si divident 41 milionë euro. Aksionarë në Telekomin e Maqedonisë, përveç qeverisë, janë edhe "Dojçe Telekom" dhe "Maxhar Telekom". Ndryshe, PTK-ja i ka të punësuar 3400 punëtorë dhe është kompania më suksesshme që ka gjeneruar të hyra gjatë vitit. ■

Mbi 2 mijë të pastrehë në komunën e Prishtinës

Të pastrehët kërkojnë strehë!

Kërkesat për zgjidhjen e çështjes së strehimit në komunën e Prishtinës janë të mëdha, ndërkohë që kjo komunë tashmë ka ndërtuar një objekt social. Zyrtarët komunalë thonë se deri në fund të muajit korrik aty do të sistemohen 48 familje të pastreha. Në kampin e të ashtuquajturës Fusha e Pajtimit në Prishtinë jetojnë 25 familje në kushte të vështira, të cilat shpresojnë të përfitojnë strehim në objektin social.

Fatos SHALA

Komuna e Prishtinës aktualisht ballafaqohet me rreth 2 mijë kërkesa për zgjidhjen e problemit të strehimit dhe në mesin e tyre janë edhe 25 familje që jetojnë në kushte të vështira, në kampin me kontejnerë të metalit, në të ashtuquajturën Fusha e Pajtimit në Prishtinë. Muhamet Gashi, zëdhënës i komunës së Prishtinës, thotë se në përpjekje për ta zbutur këtë numër, kuvendi komunal ka ndërtuar një ndërtesë sociale, në të cilën pritet të strehohen 48 familje të pastreha.“Pritet të formohet një komision i përbashkët midis komunës dhe kompanisë, e cila ka fituar koncesionin për ndërtimin e këtyre banesave dhe të bëhet pranimi teknik i objektit”.

“Posa të bëhet pranimi teknik, komuna do ta shpallë konkursin, do t’i caktojë kriteret dhe të gjithë qytetarët në nevojë, ose që nuk e kanë të zgjidhur çështjen në komunën e Prishtinës, do të aplikojnë në bazë të konkursit. Brenda dy muajsh do të kryhet e tërë procedura - konkursi edhe përzgjedhja e përfituesve. Në muajin korrik, me siguri, familjet që përfitojnë, do të hyjnë në banesa”, - thotë Gashi.

Hapja e konkursit, shpresë për banorët

Hapjen e konkursit, për të përfituar banesë në ndërtesën sociale, janë duke e pritur me padurim edhe banorët e kampit në Fushën e Pajtimit. Sabri Kastrati, banor dhe njëkohësisht përgjegjës i këtij kampi, thotë se kontejnerët, në të cilët janë të strehuar, tashmë janë amortizuar dhe nuk ofrojnë as kushtet minimale për jetesë. “Gjysma e tyre pikojnë, gjysmën i kemi rregulluar vetë. Verës është shumë nxehtë e dimrit ngrijmë nga të ftohtët. Banjat nuk funksionojnë fare. Kanalizimin e kemi rregulluar vetë... pa urbanizim. Gjendja e këtyre banorëve është e mjerueshme. Shumica e tyre jetojnë me ndihma sociale. Nuk di nëse janë dy a tri familje që kanë të punësuar”, rrëfen Kastrati. Ngjashëm e përshkruan situatën edhe Edin Mehmeti, banor i këtij kampi, i cili shfaq drojën nga ndonjë epidemi e mundshme, për shkak të, siç thotë ai, kushteve katastrofale të jetesës. “Vetë kontejnerët janë katastrofalë. Pikojnë në të gjitha anët, u është hequr materiali, i cili mbron kinse nga të ftohtët, por nuk mbron. Është e papërballueshme. Edhe fëmijët janë të sëmurë. Këtu prapa i kemi diku mbi 100 kamionë vetëm me mbeturina”. “Fëmijët luajnë aty në livadh, në fushë të sportit. Ajri i ndotur... Është shumë e mundur që të ndodhë edhe ajo - që këtu të shfaqet edhe ndonjë epidemi”, - shprehet Mehmeti.

Ndërtesë për 50 familje

Ndryshe, banorët e këtij kampi shpresojnë se komuna e Prishtinës do të gjejë një zgjidhje për ta dhe se familjet e tyre do të mund ta përfitojnë strehimin në ndërtesën sociale. “Ende nuk kemi ndonjë përgjigje nga kuvendi komunal. Dhëntë Zoti të na çojnë të gjithëve, por nuk besoj. Po thonë që ata, të cilët janë të komunës së Prishtinës, do të hyjnë aty. Ata që nuk janë, do t’i çojnë nëpër komunat e veta”. Edhe Edin Mehmeti mban të njëjtën shpresë:

“Shpresa kemi të gjithë. Se çfarë bëhet... shpresën e kemi te Zoti së pari, por edhe te këta (zyrtarët komunalë), se do të na e bëjnë një zgjidhje dhe nuk do të na lënë në këtë mjerim, sepse kjo është katastrofë e madhe”. Në anën tjetër, zëdhënësi i komunës së Prishtinës, Muhamet Gashi, thotë se të drejtën e konkurrimit për të përfituar banesë në ndërtesën sociale, e kanë edhe banorët e kampit të Fushës së Pajtimit.“Para se të shpallet konkursi, do të caktohen kriteret për familjet, të cilat duhet t’i plotësojnë ato, që të jenë përfituese. Edhe ata që për momentin shfrytëzojnë kontejnerët, e kanë të drejtën e aplikimit. Por, komuna dhe komisioni përkatës do të përpiqen që ta kryejnë punën sa më mirë dhe që përfitues të këtyre banesave sociale të jenë familjet që kanë nevojë më së shumti për strehim”, - theksoi Gashi. Sidoqoftë, zyrtarët komunalë të Prishtinës kanë paralajmëruar se së shpejti do të fillojë të ndërtohet edhe një ndërtesë sociale, në të cilën do të vendosen po ashtu rreth 50 familje me problem të pazgjidhur të strehimit. Ata kanë thënë se në vazhdimësi do të bëjnë përpjekje për të ndarë buxhet, ose për të siguruar donacione, në mënyrë që, të paktën në çdo 2-3 vjet, të ndërtojnë nga një objekt social. ■



Përfaqësues të institucioneve dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës janë të bindur se pas opinionit të GJND-së, Kosovës do t'i hapën rrugët për ecjen përpara

Pas GJND-së do të ketë njohje dhe anëtarësime

Driton BUBLAKU

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë pritet që brenda muajit korrik ta japë opinionin e saj lidhur me ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës. Ndërkaq përfaqësuesit e institucioneve dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë opinione të ndryshme rreth vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se pas opinionit të GJND-së, për Republikën e Kosovës do të ketë një fazë të re të zhvillimeve. Sipas Thaçit, vendit tonë do t'i kthehen njohjet e reja dhe do t'i hapen rrugët e integrimeve.

"Menjëherë pas prezantimit të opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), ne presim një fazë të re për Republikën e Kosovës, fazën e njohjeve të reja të perspektivës evropiane në NATO dhe në Bashkimin Evropian, në një të ardhme jo të largët edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB)", - ka thënë kryeministri Hashim Thaçi.

Ekzekutivi i vendit ka deklaruar se, pavarësisht opinionit të GJND-së, nuk do të bisedohet asnjëherë për statusin e Kosovës, por vetëm për çështje teknike.

Thaçi e ka siguruar popullin e vendit se bashkë me miqtë ndërkombëtarë do ta dërgojnë Republikën e Kosovës drejt integrimeve evropiane.

"Kosova ka rrugën e vet integruese, është rrugë e sigurt. Ne po ndërtojmë shtet demokratik multietnik, duke u mbështetur fuqimisht nga e gjithë bota demokratike.

Kryeziu: Pas GJND-së do të rriten njohjet

Edhe deputeti i radhëve të LDK-së Eqrem Kryeziu ka theksuar se është mirë të përmbyllet edhe kapitulli i GJND-së në mënyrë që Kosovës t'i hapen rrugët për të ecur përpara.

"Konsideroj se është mirë të mbyllet ky kapitull, në mënyrë që GJND-ja ta japë verdiktin e vet, duke iu hapur mundësia për njohje të reja të shtetit të Kosovës. Nuk besoj se vlerësimi i GJND-së do të ndikonte në stopimin e njohjeve të reja, aq më tepër kur të gjithë kanë deklaruar dhe po vazhdojnë të deklarojnë se pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme", - ka thënë Kryeziu.

Ndër të tjera, Kryeziu ka deklaruar se përkrah bisedimet teknike me Beogradin, por në asnjë formë, siç është shprehur, ai të bisedohet për statusin e Kosovës.

Rugova: Institucionet e paafta të përballen me GJND-në

Mendim ndryshe ka deputeti i radhëve të Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD), Naser Rugova, i cili ka akuzuar institucionet e Kosovës si të paafta ndaj përgjegjësive që dalin nga GJND-ja.

"Sa i përket GJND-së mund të them se Republika e Kosovës nuk ka koncept konkret të përgjigjes të çfarëdo opinioni vendimdhënës të GJND-së, duke e parë që kjo po e pengon shumë Kosovën dhe ritmin e njohjeve të Republikës së Kosovës nga vendet e tjera, që kanë qenë skeptike në njohjen e shtetit të Kosovës", - ka deklaruar Rugova, duke shtuar se incidentet e fundit në pjesën veriore të vendit kanë ndikuar negativisht te vendet që kanë pasur qëndrim skeptik ndaj Kosovës.

Rrustemi: Me GJND-në duhet të merremi shumë seriozisht

Ndërkaq deputeti i pavarur Naim Rrustemi ka thënë se rasti i Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë duhet të merret shumë seriozisht, duke shtuar se presionet për bisedime me Serbinë po vijnë si rezultat i afrimit të kohës për vendimmarrje nga GJND-ja.

Sipas Rrustemit, nuk duhet të ketë bisedime me Beogradin, sepse askush nuk e di se çka dhe për çka mund të bisedohet.

Fjalët që po fliten, se do të bisedohet, janë hapa të pamenduar e ndoshta të qëllimshëm për t'i mbajtur peng zhvillimet në Kosovë", - ka deklaruar deputeti i pavarur Naim Rrustemi. ■

Anketim me qytetarët e Kosovës për vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për legj

Pavarësia e Kosovës e pranueshme për GJND-në

Disa qytetarë të Kosovës janë shprehur optimistë që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë do të marrë vendim pozitiv për legjitimitetin e pavarësisë së Kosovës. Në një anketim për revistën "Paqja", ata kanë thënë se ky vendim do të sjellë njohje të reja për vendin dhe zhvillim ekonomik.

Qëndresë MUSTAFA

Presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi janë shprehur optimistë se, pas opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, do të ketë një shtim të njohjeve të shtetësisë së Kosovës.


Korab Krasniqi

Të njëjtin mendim e kanë shprehur edhe disa qytetarë të Kosovës. Në një anketim për revistën "Paqja", Korab Krasniqi, student, ka thënë se opinioni i GJND-së për Kosovën do të jetë pozitiv.

"Sa i përket vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për legjitimitetin e pavarësisë së Kosovës unë mendoj se do jetë një përgjigje pozitive në favor të popullit të Kosovës. E them këtë sepse kemi shumë aleatë botërorë që na përkrahin dhe, e dyta, mendoj se do të jetë në favorin tonë ky vendim, sepse dihet se çfarë sakrificash ka pasur vendi ynë gjatë luftërave që kanë ndodhur në Kosovë", - ka thënë Krasniqi.

Ndërsa sa i përket zhvillimeve të Kosovës pas këtij vendimi, Krasniqi ka deklaruar se ai do t'i sjellë shumë të mira vendit tonë.

"Pas shpalljes së vendimit nga GJND-ja, unë them se do të ketë njohje të reja për vendin tonë, për arsye se GJND-ja ka një peshë të madhe dhe është një indikator që do t'i stimulojë vendet e ndryshme për njohje të reja", - është shprehur Krasniqi.

Opinionin e GJND-së e ka quajtur pozitiv edhe studentja e Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës, Mirsade Spahiu. Ajo e ka bazuar këtë bindje duke parë shumë shtete të tjera që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

"Mendoj se vendimi i GJND-së do të jetë pozitiv dhe këtë e them duke u mbështetur në procesin që e kemi përcjellë në lidhje me legjitimitetin e pavarësisë së Kosovës, ku shumica e shteteve kanë qenë pro kësaj shpallje" , - është shprehur ajo.

Spahiu ka thënë se një vendim pozitiv për vendin tonë do t'i sjellë të mira popullit të Kosovës dhe vendeve të rajonit.

"Ky vendim do të jetë në të mirë të Kosovës, popullit dhe, normalisht, edhe rajonit. Pas shpalljes së këtij vendimi, nor-


Mirsade Spahiu

malisht në favor të Kosovës, mendoj se do të vinë njohje të reja për vendin dhe do të ketë interesim më të madh të vendeve të tjera për Kosovën", - ka deklaruar Spahiu.


Esat Carrabregu

Sikurse dy bashkëfolësit e tij edhe Esat Carrabregu, inxhinier i statistikës është shprehur se vendimi i GJND-së do të jetë në favor të Kosovës.

"Mendoj se vendimi i GJND-së për Kosovën do të jetë pozitiv sepse e drejta duhet të shkojë te personat ku kanë drejtësi. Por mund të ndodh gjithçka edhe gjatë marrjes së këtij vendimi, sepse serbët e kanë lobimin e fortë dhe mundohen në çdo mënyrë t'i kthejnë rrethanat nga ana e tyre, por prapë besoj se drejtësia në këtë rast do të anojë nga ana jonë", - ka deklaruar ai.

Carrabregu është shprehur optimist që, pas këtij vendimi, do të ketë njohje të reja për pavarësinë e Kosovës, por nuk shpreson se do të ndryshojë në gjendjen ekonomike të vendit.

"Besoj se do të ketë njohje të reja për Kosovën pas këtij vendimi, sepse shtetet demokratike, pas marrjes së këtij vendimi, do ta kenë më të lehtë ta aprovojnë njohjen e pavarësisë së Kosovës. Ndërsa sa i përket zhvillimit ekonomik të Kosovës pas këtij vendimi, jam shumë pesimist, sepse nuk po shoh asnjë ngritje që nga paslufta", - ka theksuar Carrabregu.

Vendimin e GJND-së për Kosovën e sheh pozitiv edhe arkitekti Luan Dalipi, i cili është shprehur i bindur që pas tij do të plotësohet numri i shteteve që do ta dërgojnë Kosovën në Bashkimin Evropian.


Luan Dalipi

"Sigurisht se do të ishte e mirëseardhur që GJND-ja ta pranonte Kosovën. Kam një bindje të fortë se ky vendim do të jetë pozitiv për vendin tonë. Ky pozitivistet do të sjellë shumë të mira për vendin, e sidomos në njohjen e Kosovës nga shtetet e tjera, në mënyrë që të plotësohet ai numri i shumëkërkuar nga ne që do ta dërgojë Kosovën në Bashkimin Evropian", - ka deklaruar Dalipi.


Shahdaze Vishaj

Ndërsa Shahdaze Vishaj, profesoreshë e gjuhës shqipe, ka thënë se të gjithë shqiptarët e Kosovës presin një vendim pozitiv nga GJND-ja për pavarësinë e vendit.

"Unë besoj dhe shpresoj, si edhe shumë shqiptarë të tjerë, që vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë do të jetë pozitiv për Kosovën, ngase edhe ata më janë të vetëdijshëm për vuajtjet e popullit shqiptar me dekada të shumta", - ka theksuar Vishaj.

Ajo ka thënë se vendimi pozitiv për çështjen e Kosovës do të hapë rrugë të shumta për vendin dhe popullin e saj.

"Shpresoj se ky vendim do të hapë rrugë të reja për Kosovën në zhvillimin ekonomik, për njohje më të shumta të pavarësisë së Kosovës, që është një e drejtë e jona e patjetërsueshme", - ka deklaruar Vishaj.

Mediet botërore, duke u mbështetur në burime jozyrtare por "të besueshme" brenda Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, ua kanë bërë me dije autoriteteve në Prishtinë dhe Beograd se vendimi i kësaj gjykate për legjitimitetin e pavarësisë së Kosovës do të shpallet më 22 korrik. ■



TALENTËT E RINJ

Në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës, nuk janë të rralla rastet e nxënësve me sukses të dalluar e të shkëlqyer. Mirëpo janë të paktë ata, të cilët janë më të zgjuar në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, të cilët kanë njohuri më të mëdha se shokët e klasës. E për këta nxënës përkujdeset edhe Ministria e Arsimit. MASHT ka Udhëzimin Administrativ, i cili e rregullon një gjë të tillë, duke i dhënë mundësinë që të bëjnë kërkesë të gjithë ata që i kanë këto veçori.

Drita VITIA

PRISHTINË, KORRIK 2010

Derisa shokët e tij po fillojnë pushimet e verës, të cilat e ndajnë vitin e kaluar më atë paraprak, Jon Konjufca është në pritje të shpalljes së konkursit për pranimin e studentëve në Universitetin e Prishtinës. Kjo, jo për shkak se shokët e tij të klasës ose të gjeneratës kanë qenë më të dobët, por sepse Joni është avancuar dhe nga klasa e dymbëdhjetë ka kaluar drejt në arsimin e lartë. Joni thotë se avancimi për të ka qenë pak i rastësishëm dhe jo diçka që ai e ka synuar. Mirëpo, meqë ai ka pas prirje në fushën e shkencave shoqërore, thotë se e ka provuar shansin dhe ia ka arritur. “Unë nuk e kam ditur se si bëhet avancimi i nxënësve, por kur kam marrë vesh prej një profesoreshe që më ka ligjëruar në gjimnazin ‘Sami Frashëri’, e kam bërë kërkesën dhe, me gjithë vështirësitë që kanë qenë, ia kam arritur qëllimit”, - thotë Jon Konjufca, njëri nga nxënësit të cilët janë avancuar këtë vit akademik nga Ministria e Arsimit. Joni ka thënë se përkundër vështirësive që ka pasur për aplikimin për avancim, meqë ka thënë se ka qenë dita e fundit e afatit për aplikim kur ai e ka marrë vesh një gjë të tillë, pas takimit me udhëheqësin e Divizionit për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim, Mustafë Kadriu, i cili sipas Jonit ka qenë shumë korrekt ndaj tij, ia ka arritur qëllimit. Meqë Joni është avancuar në fushën e shkencave shoqërore, ai edhe më tej e synon këtë fushë. Joni pret të aplikojë në njërën prej degëve në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës, ku beson se do të pranohet. Mirëpo, Joni nuk është i vetmi që është avancuar në këtë vit shkollor nga MASHT-i. Një gjë të tillë e kanë përjetuar edhe Anda Kryeziu, Mrika Sefa, Menan Berveniku, midis shumë nxënësve të tjerë, të cilët janë avancuar këtë vit shkollor për një ose dy vite shkollore. Avancimi i tyre, ose kalimi për një klasë më shumë, për shkak të talentit të treguar gjatë shkollimit të mëparshëm, ka ardhur pas vlerësimit të komisionit për avancim, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Arsimit.



Talentet e muzikës

Anda Kryeziu, e cila është avancuar për dy klasë, ka qenë nxënëse në Degën e Pianos, e cila fillimisht ishte avancuar nga klasa e tetë në të dhjetën dhe pastaj nga klasa e dymbëdhjetë në arsimin e lartë, duke e kaluar klasën e fundit ose të trembëdhjetën. Për një klasë është avancuar edhe Mrika Sefa, e cila ka kaluar drejt në arsimin e lartë prej klasës së dymbëdhjetë. Udhëheqësi i Divizionit për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim, Mustafë Kadriu, ka thënë se interesohet për të gjithë nxënësit, të cilët janë avancuar, duke shtuar se të gjithë kanë arritur sukses në çdo pjesëmarrje garuese ose diçka të ngjashme në fushën në të cilën janë avancuar. Mirëpo, jo të gjithë nxënësit janë të talentuar aq sa mendojnë. Menan Berveniku, i cili ka përfunduar klasën e njëmbëdhjetë në Degën e Pianos ishte bërë kërkesë që të avancohej për një klasë, në atë të dymbëdhjetën. Pas vlerësimit të komisionit, ky i fundit kishte vendosur që Menani të avancohej për dy klasë dhe të kalonte drejt e në arsimin e lartë. Kadriu ka thënë se komisioni ka qenë shumë i kënaqur pas vlerësimit të tij dhe ka shtuar se, menjëherë pas avancimit, ka marrë pjesë në një garë të pianos, të mbajtur në Kroaci, ku ka treguar rezultate shumë të larta.

Nxënësit e prirë për matematikë

Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në Kosovë dominojnë, me zgjuarsinë e tyre, edhe në fushën e matematikës dhe artit. Në këtë vit shkollor, në fushën e matematikës është avancuar Uran Meha, në klasën e dymbëdhjetë dhe Genta Latifi, në klasën e njëmbëdhjetë. Kryetari i Komisionit për Avancim në MASHT, Mustafë





Kadriu, është shprehur se fusha e matematikës dhe ajo e muzikës janë fushat në të cilat më së shumti dalin talente. Ai ka thënë se nxënësit e avancuar në fushën e matematikës kanë treguar rezultat pozitiv edhe në njohuri të arsimit të lartë. Kurse nga fusha e muzikës, në flaut është avancuar Marigona Qerkezi dhe në violinë Festina Haxhikadriu. Mirëpo, Ministria e Arsimit ka projekte me të cilat i vlerëson dhe i avancon edhe nxënësit me nevoja të veçanta. Ndër këto raste, më i veçanti është ai i avancimit të Rinor Ismailit, i cili ka probleme në të folur dhe të dëgjuar dhe është avancuar në dizajn grafik. Kryesuesi i komisionit, Mustafë Kadriu, ka thënë se Rinori është testuar nga profesorë të Fakultetit të Arteve, të cilët, sipas tij, janë habitur nga punimet grafike të punuara nga ai. Kadriu është shprehur se MASHT-i i bën avancimet për nxënës me nevoja të veçanta, duke i matur aftësitë e tyre gjithnjë në krahasim me nxënësit në pozitë të njëjtë.

Tre lloje avancimesh

Ministria e Arsimit, në bazë të Udhëzimit Administrativ 6/2009 të datës 20 mars 2009, sipas nenit 3, i cili ka të bëjë me të drejtën e avancimeve, ua jep të drejtën e avancimit nxënësve me njohuri të përgjithshme dhe me sukses të dalluar, nxënësve me talent në ndonjë lëndë ose fushë lëndore dhe nxënësve me nevoja të veçanta. Po ashtu, avancimet mund të jenë brenda klasës, ose brenda vitit. Kjo do të thotë se ata mund të kalojnë një ose dy klasë, ose në ndonjë rast tjetër ta kapërcejnë një nivel dhe të kalojnë drejt e në nivelin e ardhshëm. ■

Strategji apo komedi?

Fluks i madh studentësh në Universitetin e Prishtinës

Blerta MALIQAJ

Viteve të fundit, në Kosovë, është krijuar përshtypja se të gjithë ata që përfundojnë shkollimin e mesëm, patjetër duhet t'i vazhdojnë edhe studimet. 17 njësi akademike, me 17 mijë studentë në vit të parë. Matematikë e thjeshtë në dukje, por menaxhimi i gjithë këtyre studentëve do shumë përkushtim, shumë para dhe shumë hapësirë e profesorë për t'i bërë ballë këtij fluksi studentësh.

Ndoshta kjo është një përpjekje institucionale për të bërë politika të atilla që të kenë një popullatë të arsimuar. Por, për këtë numër studentësh, jorgani i Universitetit të Prishtinës është shumë i vogël.

Është e tepërt që, kushdo që ka dëshirë të studiojë, ta ketë atë mundësi. Dëshira dhe mundësia nuk janë një. Shpesh kemi dëshira, por ato mbesin të tilla, për shkak se nuk i kemi mundësitë për t'i bërë ato realitet.

UP-ja duhet të lirohet nga përgjegjësia për t'iu siguruar vende në fakultet të gjithëve, pa përfillur kushtet e studimit. Tekefundit, pse janë fakultetet e kolegjet private?

Në një intervistë për revistën UP-NEWS, rektori i UP-së, ka deklaruar se UP ka kapacitete për pranimin e 17 mijë studentëve të rinj, duke shtuar se Universiteti i Prizrenit që do të hapet këtë vit do ta shkarkojë një numër të studentëve nga UP-ja. Duke e lexuar këtë intervistë mu krijua përshtypja se nuk po flitej për studentë, por sikur rektori po fliste për shkarkim patatesh nga një depo në tjetrën.

Nëse mendojmë se kapaciteti nënkupton që gjatë ligjëratave të mos mbyllet dera për shkak të numrit të madh të studentëve, ose që shumica e studentëve të mos dëgjojnë fare se për çka flet profesori, atëherë do të pajtoheshim me rektorin, por nëse mendojmë se studim do të thotë interaktivitet ndërmjet profesorit dhe studentëve, atëherë çfarë komunikimi do të ketë profesori me studentët që nuk e dëgjojnë farë ligjërimin e tij? E kjo nuk çon te zgjidhja e problemit, por kjo është thellim në të.

Studentët e UP-së, ashtu si edhe vetë shteti, kanë nevojë për më shumë cilësi, e jo për sasi.

Ndër nevojat më primare që ka ky Universitet është sigurimi i literaturës në gjuhën shqipe, problem ky me të cilin studentët përballen çdo ditë, pavarësisht se e drejta për të pasur literaturë të mjaftueshme u sigurohet nga vetë statuti i UP-së. Krijimi i kushteve për ta zhvilluar punën praktike në të gjitha degët, pastaj lidhja e marrëveshjeve në mes të Universitetit dhe korporatave të ndryshme për t'ua mundësuar studentëve, të cilët diplomojnë, punësimin në ndonjërën prej tyre, e shumë probleme të tjera, janë shqetësuese për studentët që tashmë janë pjesë e këtij institucioni arsimor.



Ministria e Arsimit, vitin akademik që e lamë pas, nuk pati mundësi t'i bëjë ballë shtimit të numrit të mësimdhënësve në shkollat e mesme, pavarësisht se kjo ministri kishte kërkuar nga shkollat e mesme që të hapen më shumë drejtime të reja dhe të pranohen më shumë nxënës nëpër këto shkolla. Rreth 300 mësimdhënës të shkollave të mesme në Kosovë, nuk janë paguar një vit të plotë akademik. Duke u nisur nga ky shembull nuk besoj që kjo Ministri do të merret vesh me UP-në për këtë numër studentësh të rinj, sepse buxheti i Ministrisë në fjalë nuk është aq i madh sa t'i bëjë ballë pagesave të mësimdhënësve, sido qofshin ato me honorarë, a paga të rregullta.

Andaj kjo strategji e angazhimit të të rinjve vetëm sa për të mos mbetur në rrugë nuk do të dalë e suksesshme, ngase kjo çon drejt devalvimit të dijes, pasi që çdokujt po i mundësohet posedimi i indeksit dhe i diplomës së nivelit akademik. E nëse dikujt iu ka mbushur mendja se me këtë shkollim po përgatitemi për tregun e Evropës, le ta dijë se ka bërë gabim të madh sepse me këtë sasi pa cilësi Kosova po prodhon njerëz gjysmë të arsimuar.

Do të ishte shumë më e udhës që Ministria dhe rektorati të mendonin për këta të rinj më racionalisht, në vend të "ngarkim-shkarkimit" nëpër universitete. Nuk ndodh askund në botë që çdo i ri që e kryen shkollën e mesme të shkojë domosdo në fakultet. Nuk janë të gjithë të lindur për shkollë të nivelit të lartë, siç nuk janë të gjithë të lindur për t'u bërë p.sh. ushtarakë, sportistë, etj.

Andaj pyes se çfarë po ngjan me këta studentë, pasi që po i përfundojnë studimet? Do të doja që të gjitha ata, të cilët duan rritje të numrit të studentëve pa mundësi, të shkojnë në entet për punësim, ku do të shohin me mijëra aplikacione të të diplomuarve, duke pritur për ndonjë vend të lirë pune.

Këtë nuk do ta quaja strategji, por komedi. ■

BUJRUM QOTEK NË XHAMI

Isa MEHMETI

Janë shtuar tensionet fetare pas incidentit para faljes së namazit të xhumasë në xhaminë "Isa Beu" në Shkup. Bashkësia Islame e Maqedonisë kishte shkarkuar nga detyra e imamit Ramadan Ramadanin me arsyetimin se kishte shkelur kushtetutën e këtij institucioni fetar. Në të vërtetë, shqetësimi i BIM-it ishte predikimi, siç thuhet, i Islamit radikal në xhami. Krerët e BIM-it e akuzojnë Ramadanin për përhapjen e selefizmit ose siç e quajnë në mënyrë pezhorative të vehabizmit. Një shkak tjetër i pezmit të kreut të BIM-it është edhe aktiviteti publik i Ramadanit, paralel në Këshilli Koordinativ, për Xhaminë Burmali. BIM konsideron se është i vetmi institucion legjitim për ngritjen e çështjeve fetare për muslimanët në Maqedoni dhe, si rrjedhim, nëse ka çfarëdo qoftë iniciativa të tjera, ajo këtë e konsideron si ndërhyrje në kompetencat e saj. Pas ndërtimit të disa kishave me bekimin e qeverisë, Ramadani ishte më i zëshmi për rindërtimin e xhamisë Burmali (të ndërtuar më 1495), të rrënuar (më 1925) nga ish-xhandarmëria serbe. Duke ofruar dëshmi për vendndodhjen e xhamisë dhe uzurpimin e padrejtë të tokës nga ushtria serbe dhe ndërtimit në vend të saj të shtëpisë së oficerëve, Ramadani ka zhvilluar disa aktivitete për sensibilizimin e kësaj çështjeje. Ndërkohë, BIM-i ka qëndruar indiferent.

Së fundi BIM-i ka shkarkuar hoxhën Ramadan Ramadani nga pozita e imamit në xhaminë "Isa Beu", duke emëruar në vend të tij myftiun e Shkupit Ibrahim Shabanin, të cilit nuk iu lejua drejtimi i xhematit për faljen e namazit të xhumasë. Ishte Ramadani i pari, ai që e shtyri Shabanin, ndërsa më pas disa të rinj e rrokën atë për krahu dhe e dëbuan nga xhamia. Më pas, plasën disa përplasje zënkash mes përkrahësve të njërit dhe kampit tjetër, ku më së keqi e pësoi ish-deputeti i PPD-së, Eshref Aliu, i cili u godit nga disa të rinj me grushte.

Në konferencën për shtyp me gazetarë, Imer Aliu, anëtar i kryesisë qendrore të PDSH-së ka theksuar se personat e involvuar në incident ishin anëtarë të shoqatës për sigurim "Shpata", e cila, sipas Aliut, është dorë e zgjatur e krimit që drejton, dhunon e kërcënon shqiptarët dhe biznesin e tyre, që ai e lidhi me partinë shqiptare në pushtet BDI.

Vetë fakti i reagimit të shpejtë të PDSH-së, e cila gjersa ishte në pushtet ndërhyri drejtpërdrejt në instalimin e strukturave të BIM-së, tregon se e gjithë kjo zënkë fetare ka edhe prapavijë politike.

Ndërkohë myftinitë e qyteteve të Gostivarit, Tetovës dhe e Strugës, duke e dënuar incidentin, shfaqin bindjen dhe shpresën se së shpejti Myftinia e Shkupit do të gjejë zgjidhjen e duhur dhe kërkuan që "organet e hetuesisë e të gjyqësisë t'i përvishen seriozisht zbardhjes dhe gjykimit të keqbërësve", - thuhet në njoftim.

Burime brenda BIM-së, jozyrtarisht, pohuan se kjo ishte hera e parë që normat e institucionit fetar thyhen në formën më arbitrare.

Më parë, xhami problematike për BIM-in ka qenë edhe ajo e Hatunxhikut ose Jahja Pashës. Ky ishte rasti i parë që Myftinia e Shkupit u prononcua lidhur me operimin e "bandave kriminale vehabiste, të cilat në rrethin e Shkupit janë të njohura për veprimet radikale dhe për keqtrajtimin e besimtarëve muslimanë në forma dhe me metoda të ndryshme, duke shkaktuar fitne, përçarje dhe ndasi, veprime këto që bien ndesh me mësimin islam", siç thuhet në komunikatën e publikuar për media.

Kreu i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë Sylejman Rexhepi, në një intervistë për Evropën e Lirë, theksoi se "vehabitë tentojnë të bëjnë çrregullime, të shkaktojnë përçarje e urrejtje në mesin e një konfesioni, e të mos flasim më (për përçarje) mes konfesioneve të tjera. Ata, para opinionit, përdorin një gjuhë të melekve (engjëjve), e në të vërtetë brenda kësaj ideologjie fshihet një strategji e errët tronditëse. Këtu shohim një pasivitet shumë të madh të organeve kompetente dhe, me të vërtetë, është problem kur ne sot luftojmë me të gjitha forcat që kemi si shoqëri në tërësi, që të bëhemi pjesë e Evropës, nuk e di se si do ta detyrojmë Evropën të vendosë që me gjithë këto instrumente, me gjithë këto lëvizje të çuditshme për vendin, të dëmshme për shqiptarinë, të dëmshme për Islamin, të na pranojë neve në gjirin e vet. Kjo, vërtet, do të jetë një habi shumë e madhe".

Rrjedhimisht, ky diskurs i tij dëshmon se shqiptarët në Maqedoni janë të përçarë jo vetëm politikisht, por edhe fetarisht. Para pesë muajsh, Izraeli kishte tërhequr vërejtjen se në Maqedoni Islami po radikalizohej. Konfirmimi i kësaj nga kreu i BIM-së nuk është diçka që i shërben shqiptarëve në tërësi, as kombtarisht, e as fetarisht. Thirrja e organeve të ligjit, d.m.th. të policisë maqedonase për t'i qëruar hesapet mes hoxhallarëve shqiptarë, po ashtu, është një tjetër gafë e hoxhallarëve. Implikimi i partive politike në fryrjen e zjarrit, gjithashtu, është për t'u dënuar. Hoxhallarëve, ithtarë të pozicionimeve e qëndrimeve me disa dallime, u mjafton Islami për t'i zgjidhur problemet e tyre, sepse kanë më shumë gjëra që i bashkojnë sesa gjëra që i ndajnë. Televizioni maqedonas kanal 5 e quajti këtë akt skandal të hoxhallarëve, të cilët në vend se të predikojnë mëshirë në faljen javore, nxisin zënka e rrahje. Xhamia nuk është për 'qotek', por për namaz.

Së fundi, BFIM-së, në ueb faqen e saj ka akuzuar aktivistë të Qendrës për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional dhe të Forumit Rinor Islam si pjesëmarrës dhe nxitës në incidentin në xhaminë Isa Beu. Në një konferencë për media kanë reaguar të akuzuarit nga BFIM-ja, duke ofruar dëshmi se as që kanë qenë atë ditë në xhami dhe se do ta padisin në gjykatë Bashkësinë Islame për këto shpifje.

Dhe, përfundimisht, gjersa shqiptarët shahen e rrihen mes vete, maqedonasit fërkojnë duart dhe vazhdojnë ndërtimin e kishave. ■


Imamët Ramadan Ramadani dhe Ibrahim Shabani

Bukuria që të magjeps

Urë hekuri mbi lumin Valbonë



Rruga që çon drejt Luginës së Valbonës. Asfaltimi i saj është në përfundim e sipër.



Fshati Dragobi - Xhamia e cila ka mbetur në harresë



Pamje nga Lugina e Valbonës

Një nga bukuritë e rralla të natyrës alpine shqiptare është edhe Lugina e Valbonës. Gjendet në pjesën më veriore të vendit dhe në perendim shtrihet prej Qafës së Valbonës, duke vazhduar deri në luginën e lumit Drin. Është zona turistike më e frekuentuar në rrethin e Tropojës, e preferuar jo vetëm nga shqiptarët, por edhe të huajt.

Studentja me shami lobon pë



Intervistoi: Avni XHEMAJLI

Nuk është James Berisha i vetmi që bën përpjekje përtej mundësive njerëzore për të lobuar për njohjen e shtetit të Kosovës në vendet që ende nuk e kanë njohur atë. Përpjekje të ngjashme, megjithëse ende studente, i gjejmë edhe te Nora Hysenaj, një vajzë me shami, e cila i ndjek studimet e saj në një vend shumë larg Kosovës, në vitin e katërt të fakultetit juridik, në Universitetin Ndërkombëtar Islamik në Malajzi. Dallimi mes James-it dhe Nores është se, James-i duke qenë se është pilot bëri dhe është i gatshëm të bëjë lobim duke fluturuar mbi hapësirat ajrore të vendeve që ende nuk e kanë njohur Kosovën, me sloganin e shënuar në aeroplanin e tij: "Please Recognize The Independence of Kosovo" -"Ju lutëm njiheni pavarësinë e Kosovës"; kurse Nora Hysenaj ndikimin e saj përpiqet ta ushtrojë përmes pjesëmarrjes në aktivitete të garave të ndryshme të dijes, të atyre nacionale brenda Malajzisë dhe të atyre ndërkombëtare, duke synuar në këtë mënyrë t'i sfidojë kundërshtarët e saj në atë që do të mund të quhej arenë e dijes. Por ajo që James Berishën dhe Nora Hysenajn prapë i bashkon, është se asnjëri prej tyre nuk kanë gëzuar kurrfarë mbështetje institucionale për punën dhe aktivitetet e tyre që po përpiqen t'i bëjnë në dobi të shtetit tonë të ri.

PAQJA: ***Ju lutem, a mund të prezantoheni shkurt për lexuesit tonë të revistës?***

Nora: Unë jam Nora Hysenaj me prejardhje nga Plava – Mali i Zi. Shkollën fillore e kam kryer në Plavë, ndërsa shkollimin e mesëm e kam përfunduar në medresenë e mesme "Alauddin" në Prishtinë. Tani jam studente e vitit të katërt, fakulteti juridik, Universiteti Ndërkombëtar Islamik në Malajzi.

PAQJA: ***Arsimimi i juaj i mesëm sikundër e përmendet është medreseja "Alauddin" në Prishtinë. Çfarë do të thotë për ju mbulesa islame, respektivisht çfarë paraqet ajo për një vajzë apo një grua myslimane dhe a do të mund ta paramendoni jetën tuaj pa mbulesë dhe nëse jo, përse?***

Nora: Siç e dimë të gjithë, mbulesa është një obligim fetar, të cilin duhet ta zbatojnë të gjitha femrat myslimane të moshës madhore. Mbulesa islame është një mburojë e intimitetit të femrës nga syri i publikut. Ajo është shenjë e modestisë dhe mbrojtje e dinjitetit të femrës. Me një fjalë, mbulesa është pjesë e pandarë e identitetit të femrës myslimane. Në anën tjetër, njeriu që zhvishet nga identiteti shumëshekullor i popullit të tij, rrezikon të asimilohet, është jo origjinal, në një mënyrë i pavlerë dhe si i tillë pasues i verbër i së huajës. Ai që me vetë dëshirën e tij zhvishet nga identiteti, është njeri që në fakt nuk e respekton dhe nuk e vlerëson veçantinë e asaj që trashëgoi brez pas brezi. Njerëzit e tillë, i kërcënojnë vlerat autentike të një populli, madje edhe shuarjen e tij, duke i përmbysur kështu vlerat që ka dhe që e dallojnë në esencë nga popujt e tjerë. Prandaj, ai që tëhuajsohet 'vdes', sepse njeriu i tillë do të konsiderohet si një personalitet i dobët, bosh, i paqëndrueshëm që lëkundet dhe pason erën kah të fryn! Për arsyet e përmendura më lart, unë nuk do të mund të paramendoja jetën time pa mbulesën islame.

PAQJA: ***Që 3 vite ju studioni fakultetin e drejtësisë në Malajzi. Sa e konsideroni të drejtë Udhëzimin Administrativ Nr. 6/2010 që është aprovuar më dt.: 11.05.2010 nga MASHT-i për ndalimin e vijimit të rregullt të shkollimit në shkollat publike për vajzat që bartin mbulesën islame sikur që e bartni edhe ju; dhe se a mendoni që ky udhëzim administrativ duhet të shfuqizohet dhe nëse po, përse?***

Nora: Udhëzimi Administrativ Nr. 6/2010 i aprovuar nga MASHT-i, që ndalon vijimin e rregullt të procesit mësimor të shkollimit të mesëm për vajzat me mbulesë e shoh si të pabazë dhe antikushtetues. Pasi kushtetuta është akti më i lartë juridik i një shteti, çdo ligj ose dispozitë nënligjore duhet të jetë në harmoni dhe pajtim më të. Nga kjo rrjedh se çdo ligj ose akt nënligjor që është në kundërshtim me kushtetutën, herët ose vonë do të ketë fatin dështues. Po ashtu, MASHT-i që paraqiti dhe aprovoi këtë udhëzim administrativ, ka bërë një akt në tejkalim të kompetencave (ultra vires) si dhe vetë udhëzimi administrativ është një dispozitë nënligjore ultra vires – në kundërshtim me kushtetutën. Në lidhje më këtë, po që se ndalemi vetëm të neni 38, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thotë: "Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj." shihet qartë se udhëzimi administrativ në fjalë bie direkt ndesh me kushtetutën. Njëjtë bie ndesh edhe me të gjitha konventat ndërkombëtare, të cilat janë të adaptuara në nenin 22 të Kushtetutës së RKS, si p.sh. me "Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut" dhe me "Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj". Këto argumente dhe fakte të tjera si këto me bazë juridike nuk i lënë vend udhëzimit administrativ në fjalë, dhe si i tillë, është mirë që të shfuqizohet sa më parë nga vetë autoritetet përgjegjëse, për të mos e detyruar që kjo lëndë të shkojë, po e them pa nevojë, në Gjykatën Kushtetuese.

r njohjen e shtetit të Kosovës

PAQJA: ***Prej 14 deri më 21 Maj, presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu qëndroi në një vizitë zyrtare në Malajzi ku u mbajt Forumi Ekonomik Islamik Botëror me pjesëmarrje të përfaqësuesve të 62 shteteve të ndryshme të botës. Ju u takuat me presidentin Sejdiu dhe e shfrytëzuat rastin të apeloni tek i pari i vendit për lejimin e vazhdimit të procesit të rregullt mësimor të vajzave si Arjeta Halimi dhe Arlinda Zeka, që u përjashtuan më herët nga shkolla për shkak të mbajtjes së mbulesës islame. A mundeni shkurt të na tregoni se çfarë i thatë presidentit?***

Nora: Vërtet, presidenti Sejdiu dhe delegatët e tjerë nga Kosova morën pjesë në Forumin Ekonomik Islamik Botëror që u mbajt në kryeqytetin e Malajzisë, në Kuala Lumpur. Presidenti shfrytëzoi rastin për t'i ftuar biznesmenët e huaj që të investojnë në Kosovë dhe mes tjerash, t'i falënderojë të gjitha ato shtete që e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës, ndërsa shtetet e tjera që ende nuk e kanë njohur, i ftoi ta marrin këtë hap sa më parë. Studentët kosovarë që studiojnë në universitetet e ndryshme të Malajzisë patën një takim të veçantë me presidentin dhe zyrtarët e tjerë, ku ne shfrytëzuam rastin të shprehim shqetësimin tonë të thellë për problemin e mbulesës islame në Kosovë. Aktet e tilla i vlerësuam si shkelje flagrante e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si mohim të karakterit demokratik të shtetit të Kosovës dhe barrierë në rrugën e Kosovës drejt integrimit në Bashkimin Evropian. Ne po ashtu e potencuam faktin e hidhur se në kohërat e errëta për Kosovën sa ishim nën sundimin serbo-sllav, ishte pushteti diktatorial serb ai që i ndalonte shqiptarët nga shkolla, ndërsa sot, për fat të keq, e drejta për shkollim shqiptarëve po u cenohet prej vetë institucioneve tona. Fare në fund, ne kërkuam nga presidenti që qeveria e Kosovës të ndërmarr masa në zgjidhjen e çështjes dhe parandalimin e incidenteve të tilla në të ardhmen.

PAQJA: ***Në lidhje me problemin e mbulesës islame në vendin tonë, a mendoni se Kosova mund ta marrë për model Malajzinë, për zgjidhjen e këtij problemi në rrafshin e edukimit dhe mënyrën e trajtimit të drejtë të femrave me mbulesë?***

Nora: Po, pajtohem plotësisht se Kosova mund ta marrë Malajzinë për model, si në rrafshin e edukimit, po ashtu edhe në trajtimin e femrave me mbulesë. Është interesant se Malajzia ka dy Ministri të Arsimit, gjë që dëshmon kujdesin e veçantë që ajo i kushton edukimit. Fakti që sot, në shekullin XXI, ende ka shtete që adoptojnë sjellje të së kaluarës komuniste, rasti konkret në vendin tonë, duke i penguar në këtë mënyrë disa vajza qoftë totalisht ose pjesërisht nga e drejta e tyre për shkollim ose punësim shkaku i veshjes së tyre modeste, është një akt i ulët e diskriminues, që nuk përkon aspak me realitetin e kohës së globalizmit dhe të instancave drejt të cilave Kosova synon të integrohet. Është e rëndësishme për t'u theksuar se Malajzia është një shtet sekular, me rreth 60% të popullsisë myslimane, mirëpo megjithatë është një shtet demokratik me plot kuptimin e fjalës, ku askujt nuk i shkilën të drejtat, si dhe ku vajzat me mbulesë janë maksimalisht aktive edhe në progresin dhe zhvillimin e shtetit, prej të cilave gjen personalitete të larta të profileve të ndryshme, si për shembull: mjeke, profesoresha në universitete, ekonomiste, inxhiniere, avokate dhe po ashtu këshilltare në kabinetin e kryeministrit.

PAQJA: ***Në çka aludoni kur thoni se këto vajza privohen "totalisht apo pjesërisht" nga e drejta për shkollim?***

Nora: Në disa debate publike në media, thuhet nga disa zyrtarë të MASHT-it se udhëzimi administrativ 6/2010 nuk i privon vajzat me mbulesë nga e drejta për edukim, pasi ato janë të lejuara të marrin provimet me korrespodencë. Sipas mendimit tim, një arsyetim i tillë është tejet i palogjikshëm dhe i papranueshëm. Procesi i edukimit nuk definohet si 'lexim i librit dhe dhënie e provimit', por është një proces delikat që në vete përmban disiplinimin e nxënësit nga ana morale, formimin e karakterit të një qytetari të denjë, socializmi dhe shoqërimi me nxënësit e tjerë, si dhe përvojën që nxënësi e merr nga kontakti dhe ballafaqimi i tij drejtpërdrejt me moshatarët e vet. Kështu MASHT-i, nga një institucion që do të duhej të



japë mundin maksimal për çrrënjosjen e analfabetizmit, fatkeqësisht po shndërrohet në një institucion që shkakton dhe e stimulon vetë analfabetizmin. Si rezultat, ky institucion në mënyrë indirekte i privon këto vajza nga e drejta për edukim, duke ua shuar atyre entuziazmin për kërkimin e dijes dhe shkencës. Andaj kur them se këto vajza "privohen pjesërisht ose totalisht" nga e drejta për shkollim, aludoj që me këtë shprehje t'i përfshijë interpretimet jo të drejta përkitazi me udhëzimi administrativ nga ana e disa zyrtarëve të MASHT-it, siç është për shembull z. Nehat Mustafa.

PAQJA: ***Si studente e dalluar e fakultetit të drejtësisë që jeni, a mund të na tregoni edhe një gjë. Cilat janë disa nga të drejtat që feja islame ia garanton dhe ia siguron gruas, e të cilat gruaja nuk mund t'i has te civilizimet e tjera, si dhe a mund të jenë pikërisht këto prej arsyeve që në bazë të statistikave tre prej katër njerëzve në botë që sot konvertohen në Islam janë femra?***

Nora: Feja islame i garanton gruas të drejta të njëjta me mashkullin; të lidhë marrëveshje, të prodhojë, të fitojë, të posedojë pasuri në mënyrë të pavarur. Jeta e saj, prona e saj dhe nderi i saj janë njësoj të shenjta si ato të mashkullit. Por edhe, Islami i jep përparësi respektimit të nënës tri herë më shumë sesa babait, duke pasur parasysh vështirësitë nëpër, të cilat nëna kalon në shtatzëni, në lindje dhe edukim të fëmijëve. Për këtë arsye, Muhamedi (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) thotë: "Xhenneti është nën këmbët e nënës." Me një fjalë, Islami e liron gruan nga tirania moderne dhe pseudoemancipimi perëndimor, andaj ndoshta edhe ky mund të jetë shkaku që i shtyn femrat e perëndimit të konvertohen në Islam në një masë dukshëm më të madhe sesa vetë meshkujt, gjë që tregon se femrat në perëndim nuk janë edhe gjithaq të lira siç pretendohet dhe proklamohet në kontinuitet. Por sigurisht kjo ndodh edhe për arsye se Islami është fe e pastër monoteiste, ku e vërteta është e dalluar nga e pavërteta, fe e vullnetit të lirë të individit dhe jo e imponimit, por e tolerancës, e paqes dhe mirëkuptimit me civilizimet dhe fetë e tjera.

PAQJA: ***Malajzia ka qenë prej shteteve të para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe e përmendet edhe më herët se ajo e ka ndihmuar Kosovën menjëherë pasluftës. Sa është e nevojshme për shqiptarët e atjeshëm që të hapet ambasada e Republikës së Kosovës në Malajzi dhe sa do të ndikonte kjo në shtimin e njohjeve për Kosovën edhe nga shtete të tjera mike të Malajzisë?***

Nora: Malajzia si shtet i zhvilluar ekonomikisht dhe me një treg të madh konsumi prej afro 29 milion banor ka ndikim të madh në shumë shtete që nuk e kanë njohur ende Kosovën, posaçërisht në shtetet e Organizatës së Konferencës Islamike (OKI). Kur e kemi parasysh se prej gjithsejt 57 shteteve të OKI-së sa janë, vetëm 17 prej tyre deri më tani e kanë njohur Kosovën, do të duhej që sa më parë të akreditohej ambasadori i Kosovës në Malajzi, për arritjen edhe të njohjeve të tjera prej 40 shteteve të mbetura nga OKI-ja, që do të mund të finalizoheshin më lehtë dhe më shpejtë në një koordinim të ngushtë me shtetin e Malajzisë. Por do të duhej bërë edhe për arsye të pozitës gjeostrategjike që e ka Malajzia në kontinentin e Azisë dhe të lidhjeve të saj të mëdha me botën. Hapja e ambasadës do t'i forconte lidhjet diplomatike në mes të dy shteteve, duke realizuar në këtë mënyrë marrëveshje të frytshme bashkëpunimi në fusha të ndryshme, posaçërisht në ekonomi dhe arsim, pasi këta dy faktorë luajtën rolin kyç në zhvillimin e shtetit të Malajzisë. Përveç kësaj, ambasada e Kosovës në Malajzi do të ishte urë lidhëse në mes të shqiptarëve kosovarë që jetojnë e veprojnë këtu dhe institucioneve të Malajzisë, gjë që do t'ua mundësonte integrimin e tyre më të madh dhe më të shpejtë në jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike të vendit.

PAQJA: ***Duke iu dëshiruar suksese në garat tuaja të dijes, ku përveç Malajzisë do ta përfaqësoni edhe Kosovën, për fund ju lusim edhe një porosi për lexuesit e revistës tonë PAQJA?***

Nora: Për fund, do të dëshiroja ta citoj një pjesë nga fjalimi historik i presidentit amerikan, Barak Obama, i mbajtur vitin e kaluar në universitetin e El-Ezherit në Kairo. Ai tha: "E refuzoj mendimin e disave në perëndim se gruaja, e cila zgjedh t'i mbulojë flokët e saj është më pak e barabartë, por besoj fuqishëm se femrës të cilës i ndalohet shkollimi, i është ndaluar barazia".

Mjafton ta pasojmë sugjerimin e presidentit amerikan Barak Obama dhe të dëshmojmë se jemi një shtet demokratik në kuptimin e plotë të fjalës. Ju faleminderit! ■





KAMPANJA "NDAL DISKRIMINIMIN"

Vazhdon shfaqja e pakënaqësisë lidhur me udhëzimin administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, numër 6/2010, të datës 11.05.2010, që ka të bëjë me "Kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit e shkollave të mesme dhe të larta", me theks të veçantë neni 4, pika 1.13, që ka të bëjë me ndalimin e vajzave që bartin shami nëpër shkollat e mesme.

Jeton ISUFI

Nën organizimin e tri organizatave rinore: "Rinia e jonë A" nga Prishtina, "Horizonti i Diturisë" nga Peja, si dhe Organizata "Yvesa" nga Prishtina, u zhvillua një kampanjë për mos diskriminimin e vajzave që bartin shami nëpër institucionet tona, e me theks të veçantë ato që vijojnë mësimin në shkollat e mesme.

Fushata u përshkua nga një grup artistësh të rinj, të cilët pakënaqësinë e tyre ndaj diskriminimit e shprehën nëpërmjet pikturave, ndarjes së fletushkave dhe fllajerave, si dhe ngritjes së një baneri me balona me mbishkrimin 'Ky është vendimi im".

Kampanja do të shtrihet edhe në disa qytete të tjera të Kosovës. ■



Udhëzim administrativ

Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta


NUMËR: 6/2010
DATË: 11.05.2010

Neni 4

Veprimet e ndaluara

1. Nxënësit i ndalohet:

1.1. Mungesa e pa arsyeshme nga institucioni edukativo-arsimor dhe aftësues (IEAA);
1.2. Mbajtja e armëve të ftohta dhe të zjarrta si dhe mjeteve të tjera që e rrezikojnë jetën e nxënësve dhe personelit në (IEAA);
1.3. Veprimet e dhunshme si kërcënimi, konflikti, vandalizmi, mosrespektimi, fyerja, ndaj nxënësve dhe personelit në (IEAA) dhe jashtë tyre;
1.4. Bartja dhe konsumimi i drogës, duhanit dhe alkoolit në (IEAA);
1.5. Hyrja me vonesë në orë mësimi ose praktikë profesionale;
1.6. Prishja e rendit dhe e qetësisë në (IEAA);
1.7. Ta lëshojë orën e mësimit apo të praktikës profesionale pa lejen e mësimdhënësit, punëdhënësit;
1.8. Përdorimi i telefonit celular në (IEAA);
1.9. Bartja dhe përdorimi i ditarit të klasës;
1.10. Falsifikimi i dokumentacionit të (IEAA);
1.11. Kopjimi gjatë punës me shkrim;
1.12. Dëmtimi i inventarit dhe i mjeteve të punës;
1.13. Bartja e uniformës fetare.



Kundërthëniet në menaxhimin e të drejtave të njeriut

Milazim MUSTAFA

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me frymë vëllazërimi. Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë, pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër".

Kështu fillon Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. Ky akt i OKB-së është bërë një prej dokumenteve më të famshme botërore sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive njerëzore. Përveç OKB-së ekzistojnë edhe disa organizata të tjera ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e drejtave të njeriut. Ndër më të njohurat janë Amnesty Internacional dhe Human Rights Watch e kështu me radhë, të cilat merren me lobimin nëpër shtetet përkatëse ku shkelen të drejtat e njeriut, por edhe me mbrojtjen direkt të personave ose grupimeve që u cenohen të drejtat dhe liritë e tyre elementare.

Si një akt mjaft i rëndësishëm është edhe Konventa evropiane për të drejtat e njeriut, e miratuar në vitin 1950 nga Këshilli i Evropës, organ ky që kontribuoi edhe në themelimin e Gjyqit Evropian për të drejtat e njeriut, me seli ne Strasburg.

Edhe pas gjithë këtyre organeve, organizatave, institucioneve e kështu me radhë, prapëseprapë në botë ekzistojnë edhe më tej moskuptime dhe paqartësi në kuptimin e të drejtave të njeriut.

Edhe përkundër ekzistimit të shumë institucioneve dhe mekanizmave kombëtarë e ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, prapëseprapë në botë kemi raste të shumta ku bëhet thyerja e të drejtave të njeriut. Derisa nëpër vende të ndryshme të botës, në shekullin e 21-të, shkelen të drejtat elementare, si e drejta dhe liria e të shprehurit, e arsimimit, e kështu me radhë, disa vende të botës, të shtyra nga luksi i tepërt, vazhdojnë me zgjerimin e këtij koncepti. Në këtë rast, parashtrohet pyetja se deri ku do të shkohet me të drejtat e njeriut.

Në këtë rast, do të ndalemi në çështjen e të drejtave të ashtuquajtura LGBT (Lesbian, Gay, Bisexusal, Transgender). Nëpërmjet disa institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, këto të drejta promovohen si të drejta të njeriut, duke u mundësuar që personat me orientime të tilla seksuale të kenë të drejtë të shfaqin publikisht orientimin e tyre seksual, të lidhin martesat e tyre me persona të gjinisë së njëjtë, bile edhe në kategorinë e adoptimit të fëmijëve. Debate të shumta zhvillohen nëpër qarqet e ndryshme ndërkombëtare, në lidhje me këtë çështje.

Të drejtat e këtyre kategorive të njerëzve nuk janë të kodifikuara si të drejta të njeriut, sepse po të ishin në kategorinë e tillë do të ishin obliguese për të gjitha shtetet. Të drejtat për krijimin e familjeve të personave me orientime të këtilla seksuale, janë të njohura nga një numër shumë i vogël shtetesh. Problem real është se grupe të ndryshme dhe organizata të ndryshme joqeveritare bëjnë presione ndaj shteteve, kryesisht në zhvillim, që këto të drejta të njihen si drejta të njeriut.

Me këtë problem po ballafaqohen edhe shtetet tona. Me sjelljen dhe aprovimin e kushtetutës së Kosovës, nuk u specifikua çështja e martesës se ajo duhet të lidhet mes mashkullit dhe femrës, duke lënë hapësirë që akti më i lartë juridik të komentohet si hapje e derës për lejimin e martesave të çiftit të njëjtë. E njëjta gjë ndodhi edhe në Shqipëri. Shoqëria civile, nën presionin


Sali Shasivari


Bashkim Aliu

ndërkombëtar, e imponoi kryeministrin Berisha që të ndërmarrë iniciativën për legalizimin e martesave gay në Shqipëri. Presione të shumta ka edhe në Maqedoni, me rastin e sjelljes së ligjit për antidiskrimin.

Në lidhje me këtë çështje morëm mendimin e disa ekspertëve për këtë temë. Z. Sali Shasivari, i specializuar në fushën e të drejtave të njeriut, deklaroi se këto bëhen si rezultat i presioneve të ndryshme nga perëndimorët, të cilët kanë marrë poste të larta nëpër institucionet evropiane e assesi nuk janë standarde të BE-së. Po theksojmë, nga individë e jo kërkesa zyrtare të BE-së ose të NATO-s. Organizatat e ndryshme, financojnë dhe përkrahin persona të afërt me idetë e tyre dhe të njëjtit persona i infiltrojnë nëpër institucione të BE-së dhe nëpërmjet tyre, pastaj bëjnë presione nëpërmjet komunikatave, rezolutave, kërkesave e kështu me radhë, duke bërë presion mbi qeveritë e shteteve që të njohin këto të ashtuquajtura të drejta të njeriut. Nëse ne i referohemi demokracisë, si sundim i shumicës, atëherë edhe në këtë rast duhet të respektohet vendimi dhe mendimi i shumicës. Shumica e popullatës së vendeve të botës, por edhe vendeve tona, është kundër martesave të çifteve të njëjta, deklaroi Shasivari. Në lidhje me këtë, teologu i njohur Mr. Bashkim Aliu, potencoi se në aspektin islam, personat e tillë llogariten si persona me deformim të caktuar. Andaj personave të tillë duhet t'u ofrohet ndihmë dhe shërim. Zgjidhje momentale për tipat e tillë është



izolimi i tyre dhe ndalimi i kontakteve të tyre me shoqërinë, nëse ata i manifestojnë publikisht orientimet e tyre. Homoseksualizmi nuk është vlerë evropiane, pasi se si i tillë është i njohur vetëm në katër shtete të Evropës. Gjithashtu, edhe Vatikani ka qëndrimin e tij zyrtar në lidhje me këtë çështje. Prandaj, qeveritë tona duhet të kenë guximin që t'i refuzojnë këto kërkesa nga diplomatët dhe politikanët anonimë, që vijnë nga Brukseli a Strasburgu.

Juristi i njohur prof. dr. Afrim Osmani thotë se në këtë rast kemi të bëjmë me botëkuptime të ndryshme ndaj vlerave njerëzore, kemi të bëjmë me qasje jo të njëjta ndaj problemeve, ashtu siç janë edhe: homoseksualizmi, tribadizmi dhe martesa e gjinive të njëjta. Për disa shtete, çështjet në fjalë paraqesin orientim njerëzor, paraqesin diskurs demokratik, e për disa të tjerë këto çështje paraqesin tejkalim të kufirit, tejkalim të vijës së kuqe, braktisje të vlerave njerëzore. Andaj, në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që këto të ashtuquajtura "vlera" njerëzore, që paraqesin armë për shkatërrimin masiv të shoqërisë, të paraqesin kushte të patjetërsueshme për aderimin e shteteve në strukturat euroatlantike. Sepse, si të tilla, ato nuk mund të jenë. Ato janë vetëm kërkesa të grupeve të ndryshme të interesit. Përkundrazi, këto dukuri shkatërruese duhet të luftohen dhe të çrrënjosen nga shoqëritë tona, për arsye se këto "vlera" na çojnë në një shoqëri pleqsh, në një shoqëri pa familje, ose thënë ndryshe, në një shoqëri ku fëmija-bebja zëvendësohet me qenin apo macen.

"Problem i ngjashëm, por me qasje të kundërt, është edhe çështja e shamisë për femrat muslimane. Në disa vende perëndimore, por edhe lindore, cenohet e drejta e femrave muslimane që të bartin shaminë në vende publike, si rezultat i bindjeve të tyre fetare, që të jenë të integruara në shoqërinë e përgjithshme, ashtu siç edhe kërkon feja. Kohëve të fundit ishte aktual edhe akti nënligjor në Kosovë, që ua ndalon femrave muslimane që të ndjekin mësimin nëpër shkollat e mesme me mbulesë në kokë.

Po të analizojmë të gjithë kushtetutat e vendeve demokratike, deklaratat dhe aktet e tjera të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, do të shohim se në asnjërën prej tyre nuk hasim gjëra të tilla. Të gjitha ndalesat e këtij lloji janë me akte nënligjore të qeverive aktuale. Kjo do të thotë se këto ndalesa vijnë si rezultat i politikave programore të partive qeverisëse. Në raste të tilla, mund të themi se bëhet fjalë për mospërcaktim të nocioneve demokratike dhe ushtrim të ndryshimit të demokracisë", - deklaroi Mr. Bashkim Aliu.

"Çështja e shamisë, jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë, keqkuptohet. Shpeshherë shaminë e vënë në rangun e elementeve të tjera fetare, p.sh mbajtja e kësulës, mbajtja e kryqit etj, që në fakt paraqesin simbole fetare, gjë që nuk vlen edhe për shaminë, sepse shamia në fenë islame llogaritet si obligim. Si shkak për përjashtimin e shamisë nëpër institucionet shkollore dhe ato shtetërore merret fakti se në këto institucione nuk ka vend për simbole fetare dhe se shtetet e sotme demokratike janë shtete laike dhe se, në asnjë mënyrë, nuk guxojnë ta rrezikojnë karakterin sekular, ose ndryshe thënë, janë shtete ku ka një vijë të trashë mes shtetit dhe religjionit", - shprehet prof. Afrim Osmani. Republika e Kosovës, në vend që të konsolidohet si shtet demokratik, bashkëkohor, në të cilin do të sundojë e drejta dhe shteti ligjor, po pengon në mënyrë drastike ecurinë drejt arsimimit të femrës. Në këtë shtet, në vend që të luftohet më ashpër korrupsioni dhe të gjitha dukuritë e tjera negative të shoqërisë, ku vazhdimisht thyhen të drejtat elementare, ku ndër më të rëndësishmet që vlen të potencohet është çështja e pronës, me ç'rast të rrallë janë ata pronarë që kanë shpëtuar nga grupet e ndryshme kriminele që mbledhin "haraç", gjë që në mënyrë direkte pengon avancimin e bizneseve të tyre, ata merren me pengimin e vijimit të procesit edukativo-arsimor të vajzave me mbulesë. Një gjë duhet ta kenë të qartë udhëheqësit, si ata të nivelit lokal ashtu edhe të atij qendror, se standard më i lartë dhe më i përgjithshëm ndërkombëtar është respektimi i popullatës së tyre, që jeton në atë shtet", - shprehet prof. Osmani.

Shpresojmë që, para se të votohet ndonjë ligj a rregullore, të shqyrtohen të gjitha anët pozitive dhe negative që bart në vetvete një akt i tillë juridik. Sepse, ata që e njohin filozofinë e funksionimit të sistemit juridik e kanë parasysh se kopjimi i ligjeve dhe rregulloreve të shteteve perëndimore me formulën copy-paste, nuk mundëson zhvillimin normal të një sistemi vendor të shtetit. Këtë nuk e imponon as Unioni Evropian. Po mos të ishte kështu, nuk do të kishim shtete të shumta evropiane që kanë dallime të dukshme në sistemet e tyre dhe në qasjet e tyre ndaj fenomenit të të drejtave të njeriut. Unioni Evropian parasheh institutin e harmonizimit dhe jo të kopjimit të rregullativave ligjore. ■

Autori është jurist



Eksponatet - dëshmi të vuajtjes dhe krenarisë

Astrit VELIQI

Një ditë e pazakontë pranvere, bukur e vranët ishte atë ditë kur vizituam Muzeun e Kosovës, vend ky ku qetësia dukej sikur mbështillej kudo, e madje edhe në eksponatet prej metali.

Heshtja që mbretëronte në objektin e muzeut të linte përshtypjen sikur nuk kishte frymë njeriu brenda, por në katet e larta të tij, në një zyrë modeste ku kishte fotografi ushtarësh në stol, stema e flamuj të shumtë, ishte njeriu që, ulur pranë kompjuterit të tij, punonte me zell e përkushtim për ruajtjen dhe sistemimin e ekpsonateve të shumta të luftës, që janë dëshmia më e gjallë e historisë sonë shekullore.

Ky ishte Mr. Sadik Krasniqi, shef i Sektorit të Historisë në Muzeun e Kosovës, i cili na rrëfen për përkushtimin e tij të madh në mbrotje të këtyre eksponateve, që si relikte të kohës kanë mbetur si trashëgimia më sublime e vendit tonë.

Rreth 50 mijë eksponate të sistemuara të luftës së UÇK-së

Ai thotë se, që nga paslufta e këndej, sektori i historisë në Muzeun e Kosovës ka arritur të grumbullojë rreth 50 mijë dëshmi dhe eksponate të luftës së UÇK-së.

Krasniqi tregon se ky sektor bën mbledhjen dhe ruajtjen e të gjitha dëshmive që kanë të bëjnë me trashëgiminë e popullit tonë.

"Vetëm në periudhën e fundit, që nga paslufta e këndej janë grumbulluar rreth 50 mijë dëshmi dhe janë realizuar 4 ekspozita tematike, që kanë të bëjnë me këtë periudhë historike.

Ai tha se këto dëshmi e eksponate janë tri llojesh: si dëshmi tridimensionale, fotografi dhe harta e dokumente të ndryshme.

Sipas tij, burimet ku janë marrë këto lloje dëshmish janë nga tri shoqatat e dala nga lufta, TMK-ja (FSK-ja), si dhe disa institucione të tjera që merren me arkiva, por edhe gjatë grumbullimit në shumë familje të ndryshme.

Krasniqi tha se është shumë e dhimbshme të tregohen rastet kur familjarët na kanë dhënë dëshmitë dhe eksponatet e bijve dhe të bijave të tyre. Në disa raste lotët, por edhe krenaria, bëhen bashkë.

Ruajtja, por edhe konservimi i këtyre eksponateve bëhet në Muzeun Kombëtar të Kosovës.

Ai tregon se këto dëshmi, ose eksponate të luftës, kanë përmbajtje të ndryshme, si: hekur, dru, koleksione rrobash dhe mëndafshi.

Sipas tij, të tria këto lloje kërkojnë tretman të veçantë në ruajtjen, por edhe mbajtjen e tyre, ngase shumë prej tyre, siç janë eksponatet që janë nga hekuri, nëse nuk konservohen dhe lyhen me material përkatës, në të shumtën e herëve edhe shkatërrohen.

"Muzeu posedon material të tillë, por ai nuk është material përkatës. Në këtë aspekt, ndihmë të konsideruar ka dhënë TMK-ja, por edhe KFOR-i, pasi në shumë raste kanë bërë edhe lyerjen me materialin përkatës.

Rast konkret me dëshmitë e luftës, sipas Krasniqit, është kompleksi "Adem Jashari" në Skenderaj, ku nga moskonservimi si duhet i shumë eksponateve me material përkatës, shumë prej tyre dhe janë prishur."

Mbi 2.000 eksponate në muzetë e Beogradit

Krasniqi thotë se sektori i historisë para lufte ka pasur mbi 20 mijë dëshmi e eksponate të ndryshme, kurse me dëshmitë e luftës së UÇK-së, numri arrin në rreth 80 mijë eksponate.

"Po që se llogarisim dëshmi, fotografi të ndryshme, duhet të cekim se mbi 2.000 eksponate, që nga koha e pasluftës, janë duke qëndruar në muzetë e Beogradit, të cilat, edhe pas kërkesave të shumta, nuk janë kthyer", - shprehet Krasniqi.

Fjala është për fotografi, dokumente, që nga koha e mesjetës e deri te dëshmitë e Konferencës së Bujanit.


Sadik Krasniqi

Krasniqi thotë se në Muzeun e Kosovës janë duke u ruajtur dëshmi e eksponate nga më të ndryshmet, si: ato që i takojnë krenarisë së UÇK-së, siç janë armët, uniforma e relikte të tjera, mandej nga segmenti i intervenimit të NATO-s ka dokumente, fotografi, segmente të gjenocidit, si rrobat e femrave të dhunuara, armë të ftohta, shpata të përgjakura nga masakra të ndryshme, si dhe dëshmi nga segmenti i etnocidit ose i dëbimeve gjatë luftës.

Eksponatet e luftës së UÇK-së në Kosovë janë dëshmi dhe dokumente shumë të rëndësishme, të cilat është më se e nevojshme që të ruhen.

Lufta e fundit në Kosovë ka qenë njëra nga periudhat më tragjike, andaj edhe janë ruajtur dëshmitë më interesante dhe më rrënqethëse të kësaj periudhe.

Disa familjarë këto eksponate i ruajnë në shtëpi, disa ia kanë dhënë Muzeut të Kosovës, kurse një numër tjetër i familjarëve kanë shumë pak dëshmi të kësaj periudhe.

Rrëfimi për këto relikte të çmuara po aq sa zgjon krenarinë kombëtare, po aq edhe rikthen plagët e dhimbjes ndër shekuj, megjithatë, vetë imazhet që ato sjellin para syve të njeriut japin një çikë shpresë se e nesërmja do të zbardhë më e mirë për të gjithë. ■

Letra e Aliut drejtuar banorëve të Irakut

Tek Aliu r.a. kishin shkuar Haxher Ibën Idij, Amër Ibën El Hamk dhe Abdullah Ibën Vehab El Rasibij dhe i thanë: 'Çfarë ke për të na thënë për Ebu Bekrin dhe Omerin, gjithashtu edhe për Osmanin radijAllahu anhum?'

Aliu, *Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*, u tha: "Jeni të brengosur për këtë? Apo keni hallin që po pushtohen qytete dhe po vriten shumë prej ithtarëve të mi? Për këtë unë do t'ju shkruaj një letër, ku do të gjeni përgjigjen e pyetjes suaj. Ndërsa ju do t'ua lexoni ithtarëve të mi".

"Allahu i Lartmadhëruar e dërgoi Muhamedin s.a.v.s. këshillues të njerëzimit dhe besnik të Shpalljes së Tij. Atë e bëri dëshmitar të umetit të Tij, ndërsa ju, o arabë, ishit të pafe dhe jetonit një jetë të shthurur. Ishit shumë të pamëshirshëm, vriteshit midis vete, vrisnit fëmijët tuaj dhe hanit pasurinë e të tjerëve pa të drejtë. Allahu ua ndaloi të gjitha këto, duke ju dërguar Muhamedin, njeriun i Cili ishte njëri prej mesit tuaj dhe i Cili fliste gjuhën tuaj.

U bëtë besimtarë, ndërsa Muhamedi, si i juaji, jetoi me ju. E njohët fytyrën e tij dhe lozën e familjes së tij. Ju mësoi Librin, urtësinë, ju bëri me traditë dhe ju caktoi obligimet. U urdhëroi të jeni të mëshirshëm, të mos vriteshit dhe ju reformoi plotësisht, duke ju bërë që të duheni mes vete. Ju mësoi se si të ruhet amaneti dhe të mbani premtimin, ju mësoi si të jeni të butë e të sjellshëm, mbi të gjitha, ju mësoi si të jeni të mëshirshëm.

Ju ndali zullumin, xhelozinë, perversitetin dhe papastërtitë. Ju ndaloi pirjet dehëse dhe të mos vidhni në peshore. Të gjitha këto që jua dha, buronin nga sjellja dhe veprat e një njeriu të sinqertë dhe të devotshëm. Ai ishte larg veprave të këqija, prandaj ju ndaloi të prostituoni dhe të hani pasurinë e jetimëve pa të drejtë. Ua dha çdo të mirë që ju largon nga zjarri (xhehenemi) dhe ua ndaloi çdo të keqe që u largon nga xheneti.

Kur i plotësoi ditët e tij të kësaj bote, Muhamedi s.a.v.s. vdiq i kënaqur me ju dhe me veprën e tij. Ai ishte i falur nga mëkatet e Tij. Ishte i dëlirë te Zoti i Tij, por fatkeqësisht vdekja e tij u bë sprovë për të afërmit e Tij dhe mbarë besimtarët. Kur shkoi ai, filloi grindja midis muslimanëve!

Ju betohem se,

nuk më ka shkuar asnjëherë ndërmend se një ditë arabët do të kërkojnë nga unë drejtësi. Nuk më frikësoi pëlqimi i njerëzve ndaj Ebu Bekrit, sepse ai nuk ju terrorizoi, por unë e ndrydha dorën time sepse pashë se ndër njerëz isha më meritor se ai në vend të Muhamedit, duke pasur parasysh përgjegjësitë që më ngarkoheshin. Qëndrova në këtë gjendje aq sa ishte vullneti i Allahut.[1] Kur pashë se njerëzit filluan të anojnë nga ai, u ktheva drejt Islamit që të bëhemi një zë në përparimin e fesë së Muhamedit dhe miletit të Ibrahimit alejhimas selam.

U frikësova se mos po e humbisja ngadhënjimin e Islamit, e mos të isha njëri prej pasuesve të tij. Nuk dëshiroja të shikoja një Islam të thyer e të shkatërruar, që do të ishte një katastrofë për ne, e kjo të shkaktohej si pasojë e prijësit tuaj, gjë që është një ndjenjë e përkohshme, e cila do të largohej prej atij vendi shumë shpejt, mu ashtu siç është mirazhi.

Prandaj, shkova tek Ebu Bekri dhe ia dhashë besën, qëndrova me të në ditët e tij më të vështira, derisa u pastrua e kota dhe u bë që Fjala e Allahut të jetë mbi të gjitha fjalët. Qëndrova me të derisa u mposhtën qafirët. Ebu Bekri i përjetoi ditët e tij më të lumtura, ditë, të cilat iu lehtësuan atij, duke i penguar keqbërësit dhe duke i afruar të mirët. Kështu vendi po përparonte, ndërsa unë i qëndroja besnik dhe e këshilloja. E kam respektuar aq sa ai i qëndronte besnik fjalës së Allahut.

Kur i erdhi koha të ndahej nga kjo jetë, caktoi Omerin prijës të cilin të gjithë e dëgjuam dhe e respektuam. Të gjithë ia dhamë besën dhe e këshilluam. Kështu shkuan punët për së mbari. Kishte një biografi të shkëlqyer, kënaqeshim me pastërtinë e ditëve të jetës së tij. Kur edhe këtij po i vinte fundi, mendova në veten time se mbase mos po më cakton prijës,[2] por ai përcaktoi komisionin konsultativ-shura, në të cilën më vendosi në mesin e gjashtë kandidatëve.

Askush prej kandidatëve nuk e urrente postin më shumë sesa unë. Të gjitha ata më kishin dëgjuar kur kisha polemizuar Ebu Bekrin duke i thënë: "O populli i kurejshitëve, unë jam më meritori nga ju për këtë post, askush nuk e lexon Kur'anin dhe as nuk e di rrugën e Pejgamberit më mirë se unë. Ata u frikësuan se po të bëhesha prijësi i tyre,[3] ata[4] nuk do të kishin mundësi të vinin në postin e prijësit dhe u betuan njëzëri për një njeri të vetëm dhe kështu u larguan nga unë për ta marrë Osmani postin e prijësit. Më nxorën prej aty, duke më thënë se do ta diskutonin edhe më tutje këtë çështje. Më pas kërkuan me ngulm që t'ia jap besën, përndryshe do të më sfidonin. Ua dhashë besën pa dëshirën time, duke ndrydhur durimin tim.

Njëri prej tyre tha: 'O biri i Ebu Talibit, paske qenë shumë i kujdesshëm'. I thashë: "Ju jeni më të kujdesshëm. Ishte e drejta ime t'ia kërkoja trashëgiminë vëllait tim dhe të drejtën e tij, po ju sikur të kishit ndërhyrë midis meje dhe tij, do të më godisnit mua e jo atë!"

O Zot,

unë kërkoj ndihmë nga Ti kundër kurejshitëve, sepse më këputën familjen, më nënvlerësuan dhe më poshtëruan, por më e keqja nga e gjithë kjo ishte, kur ata më thoshin duro, mposhte zemërimin dhe jeto i ngushëlluar.

Po shikoja përreth meje se kush do të më shoqëronte përveç familjes sime. Pashë shkatërrimin, i mbylla sytë, por vallë, si ta pranoja robërimin dhe shqetësimin tim! Durova erën e jashtëqitjes që të mos kuptohesha se mos vallë jam lakmitar dhe parapëlqeva dhembjet në zemër nga dridhjet e hekurit, derisa u hakmorën ndaj Osmanit dhe e mbytën.

Më pas erdhët tek unë që të më jepnit besën. Ua refuzova. Ndërsa ju refuzuat refuzimin tim, hapët debat dhe u përpoqët të më bindnit. Nuk ua zgjata dorën dëshirës suaj, derisa u bëtë shumë në numër, derisa mendova se do të vriteshit mes vete dhe do të shndërroheshit në katilë. Ndërsa vazhdonit të thoshit se nuk kemi askënd tjetër, përveç teje. Betoheshit se nuk do të pajtoheshit me askënd tjetër, kërkuat t'ua jap besën e të mos bëhesha ai që po e ndaj dhe përçaj umetin. Në këtë situatë, ua dhashë besën dhe kërkova që njerëzit të betohen.

Atij, që ma dha besën me vullnetin e tij, ia kam pranuar atë. Ndërsa ai i cili e refuzonte, e kam lënë të lirë. Të parët që ma

dhanë besën ishin Talha dhe Zybejri, po sikur të ma refuzonin asnjëherë nuk do t'i urreja, mu ashtu siç nuk i kam urryer të tjerët. Ata nuk qëndruan shumë, zgjodhën rrugën e tyre më të lehtë derisa u informova se kishin dalë me ushtrinë e tyre për në Basra. Secili prej tyre më kishte respektuar, por e thyen besën.

Ndërhynë në administratë,


në depot dhe në zyrat e thesarit që ishin në përgjegjësinë time. Gjithashtu, ndërhynë në popullin që ishte nën administrimin tim dhe filluan t'i përçajnë edhe pse ishin ithtarët e mi. Filluan e mbytën një grup prej tyre, të cilët ishin të pambrojtur, një grup tjetër duroi, ndërsa një grup tjetër ngriti shpatat, por shumica e tyre u bënë shehidë. Vallahi, sikur njëri prej tyre të vritej me paramendim dhe qëllim të keq, do t'ju shpallja luftë, sepse do të më lejohej vrasja e gjithë ushtrisë së tyre, edhe pse vranë një numër të konsiderueshëm të muslimanëve, por ishte vullneti i Allahut që ata të shihnin te vetja atë sa për t'i shpëtuar dënimit, sepse ishin larg të qenit popull zullumqar.[5]

Më pas drejtova shikimin tim drejt Shamit.[6] Ç'të shoh, atje ishin grumbulluar arabë, parti të ndryshme, lakmitarë e banditë të çdo lloji. Shumë prej tyre duhej të merrnin mësim edukimi, sepse nuk ishin as prej muhaxhirëve, as prej ensarëve, e as prej tabiinëve të mirë, gjithsesi, prej tyre pritej shumë në të ardhmen. Mbivlerësuan veten, prandaj duhej t'i ftoja në xhematë dhe të mësonin se si të respektonin. Fatkeqësisht edhe këtë e refuzuan dhe, gradualisht, shtohej urrejtja dhe mosbesimi i tyre. Për ta ruajtur pozitën e tyre, ata iu drejtuan muhaxhirëve, ensarëve dhe tabiinëve me mirësjellje. Me ta silleshin me butësi dhe mençuri, ndërsa në anën tjetër i trimëronin për sulme, kështu që, u detyrova t'i luftoja.

Kur rezistenca e tyre e armatosur po mposhtej[7] dhe kur e ndien dhembjen në palcë, ngritën Mus'hafet[8] që t'ju mashtronin, kinse të gjykonim sipas tij. Ju paralajmërova se ata nuk janë dashamirë të fesë ,e as të Kur'anit. Ngritja e mus'hafëve ishte një tradhti dhe mashtrim i radhës. Ndaluat luftimin dhe më akuzuat mua. Më thatë që të pranoja ftesën e tyre, nëse ata do t'i përgjigjeshin Librit dhe traditës së Pejgamberit, sepse do të ishte një bashkim, i cili ishte i dëshiruar prej nesh dhe prej tyre. Nëse do të refuzonin, do të ishte një arsye edhe më e fortë kundrejt tyre, dhe u detyrova ta pranoj, duke ua lehtësuar atyre të ardhmen.

Ndërsa paqja midis tyre dhe midis nesh do të varej vetëm në "dy persona të urtë"! Kinse këta dy do ta fusnin në praktikë atë që lejonte Kur'ani dhe, do ta varrosnin atë që ua ndalonte Kur'ani. Por mendimet e tyre ishin krejtësisht të ndryshme dhe kështu u ndanë parimet e "urta të tyre" dhe u përbuz Gjykimi i Kur'anit, duke i kundërshtuar parimet e tij. U përcaktuan për pasionet e tyre, duke mos ia vënë veshin udhëzimeve të Allahut. Kështu na sollën në këtë situatë, sepse ishin ithtarë të këtij mendimi.

Nga ky takim dolën edhe më të paqartë, pastaj rrodhën grupe të tjera, të cilat u detyruam t'i linim anash, ashtu siç edhe ata na lanë anash. Disa prej tyre u bënë kriminelë, filluan të vrisnin besimtarë të pafajshëm. Këtyre duhej t'iu shkonim dhe t'iu kërkonim që të na linin të lirë vrasësit e vëllezërve tanë.[9] Ndërsa ata na kthyen përgjigjen se të gjithë ishin vrasësit e tyre, dhe se, të gjithë ata ia kishin lejuar vetes gjakun e tyre, dhe gjithsesi gjakun tonë. Prandaj u ngushtuam shumë nga të bëmat e tyre dhe na detyruan që ta ndalim hovin keqbërës të tyre.



Pasi përfunduam, ju urdhërova

të shpejtonit kundër armikut tuaj, sepse do të ishte më mirë për të ardhmen tuaj që ju ta ndalonit të keqen që në fillim dhe t'i parandalonit intrigat e tyre. Ndërsa ju, si m'u përgjigjët: 'Na janë rënduar shpatat dhe parzmoret tona, na janë thyer mburojat, na janë mbaruar shtizat dhe shigjetat'. Më thatë që t'ju urdhëroj të ktheheni derisa të përgatiteni me më të mira se ato që i kishit, e kur të ktheheshit do të ishit më të freskët dhe më të gatshëm për beteja të tjera dhe se do ta shkatërronit secilin armik që do t'u dilte përpara dhe secilin grup që do të mundohej të ndahej prej jush.

Thatë se kështu do të ishit më të fuqishëm kundrejt armikut, u pajtuat para se të mbërrinim në Kufe, mirëpo, unë ju urdhërova që t'i ngrinit çadrat e kazermës suaj, që secili prej jush të dijë vendin e vet dhe të bëheshit të gatshëm për xhihad. Ju kërkova që të mos vizitoni shpesh fëmijët dhe gratë tuaj, sepse kjo do t'ua zbuste zemrat tuaja. Ju thashë se kundërshtarët tuaj nuk kanë kohë për të humbur, ata janë zgjuar gjatë gjithë netëve të tyre, sepse ata nuk flenë shumë, e shfrytëzojnë ditën racionalisht dhe nuk i mbushin barqet e tyre aq sa duhet, derisa të mësojnë mbi rezultatin e tyre. Ata do të vazhdojnë t'ju mashtrojnë derisa të korrin fitoren e tyre.

Një grup zbriti me përtesë, ndërsa grupi tjetër hyri në qytet kokulur. As grupi që zbriti nuk duroi derisa të dëshmohej e vërteta, as ata që shkuan në qytet nuk u kthyen më. Ju e patë se në kazermë nuk mbetëm më shumë se pesëdhjetë burra. Kur u pashë ju që nuk erdhët, hyra te ju dhe deri tani nuk jeni në gjendje të dilni me mua.[10]

Të Zotit janë prindërit tuaj, çfarë po prisni ju thashë? A nuk po shihni se çdo gjë përreth jush po shkatërrohet dhe çdo qytet i juaji po pushtohet? Çfarë po ju bën të heshtur?! A nuk janë ata që po grumbullohen e po këshillohen, ndërsa ju po shpërndaheni e po kundërshtoheni, kështu vetëm sa po e mashtroni veten?

Grumbullimi juaj

do të thotë ngritje, prandaj zgjohuni. Zoti do t'ua plotësojë këtë gjumë që të bëheni të gatshëm kundër armikut tuaj, sepse jeni duke i luftuar të përdalët dhe bijtë e të përdalëve, të cilët

kanë hyrë në Islam pa dëshirën e tyre. Ata që luftuan Pejgamberin s.a.v.s. ishin armiqtë e traditës dhe të Kur'anit, ishin ithtarët e partive 'reformatore', që shkaktonin vetëm probleme. Ata që u shkojnë mbrapa këtyre janë frikacakë, sepse janë të frikësuar prej tyre, ndërsa fenë e kanë të devijuar. E pranojnë të huajën, sepse besojnë vetëm këtë botë.

Më përgojojnë mua, që biri i të poshtrit Muaviu të mos ma japë besën. E kanë kushtëzuar atë që t'i korruptojë me pasuri më të mëdha se sa ka pasuri nën pushtetin e tij. E boshatisa dorën e shitësit të fesë dhe të dynjasë! Ia mbusha blerësit dorën me dhe, nga përfitimet e tij të ndyta e të përkohshme, i cili është pasuruar me pa të drejtë nga pasuria e të tjerëve. Prej tyre ka të atillë që do t'ju kërkojnë të bëheni pjesë e pijes haram, pastaj në mesin e tyre ka që janë rrahur me kamxhik, pasi kishte vendosur gjyqi islam. Këta pra, tani e tutje do të bëhen udhëheqësit tuaj. Ai i cili do të lihet, do t'i kujtohen të bëmat e tyre të këqija dhe dëmet e mëdha.

Këta që do t'ju sundojnë do të jenë ata që do t'ju poshtërojnë akoma më shumë, do t'ju lavdërohen për të arriturat e tyre, të cilat i kanë marrë me anë të forcës dhe kështu do t'ju shtohet akoma më shumë dhembja, hidhërimi dhe gjithsesi edhe degjenerimi. Prandaj mos i përcillni pasionet e tyre dhe mos u korruptoni, derisa nuk jeni dorëzuar akoma.

Mbështetja te dijetarët tuaj të mirë është udhëzim i rrugës suaj. Mos iu ndani shkencëtarëve, fukahave[11], atyre që merren me Kur'anin. Mos iu ndani veprimtarëve që punojnë gjatë natës-muxhtehidëve, atyre që janë të devotshëm, asketëve, atyre që ndërtojnë xhami dhe lexuesve të Kur'anit. A nuk zemëroheni, e nuk do të hakmerreni që shtetin tuaj do ta sundojnë injorantët, të poshtrit dhe keqbërësit nga mesi juaj?!

Dëgjojeni fjalimin tim, kur t'ju them diçka dhe respektojeni urdhrin tim kur t'ju urdhëroj. Kuptojeni këshillën time kur t'ju këshilloj, besojini vendimet e mia kur t'ua jap ato. Përqendrohuni në seriozitetin tim kur më shihni serioz, mos neglizhoni kur ju kërkoj vëmendje të plotë dhe mos u bëni mendjemëdhenj kur ju paraqitem me thjeshtësi. Edhe sikur të gaboni ndaj meje, kërkoj që mos t'ju bëhet udhëzim dhe mos u bashkoni kundër meje. Kur të shkoni në luftë përgatituni mirë që të fitoni, sepse zjarri është ndezur dhe ata që e kanë ndezur mundohen të nxjerrin zullumqarin. Ashtu siç mundohen ta shuajnë dritën e Allahut, mundohen t'ju shkatërrojnë edhe ju.

O robër të Allahut,

a nuk janë vallë, ithtarët e shejtanit lakmitarët dhe përbindëshat, ata që paraqiten seriozë gjatë mashtrimit, humbjes dhe veprave të kota të tyre, karshi atyre që mundohen ta mbrojnë e pastrojnë të vërtetën, duke dhënë lajme të mirëqena dhe që mundohen t'i jenë nënshtruar vetëm Allahut dhe që këshillohen me imamin e tyre?

Unë, vallahi, sikur të mbetesha i vetëm do të qëndroja karshi të gjithë atyre që kanë për pasion këtë botë, do të isha shumë i ashpër me ta dhe do të përpiqesha t'i udhëzoja në rrugë të drejtë të humburit e tyre. Mbase vizioni, bindja dhe argumentet e mia do të ishin nga Zoti im dhe kështu do ta takoja Zotin tim i kënaqur, sepse të mirat gjithmonë të kthehen, ndërsa neglizhenca do të më turpëronte. Rrjedhat e ngjarjeve po më edukojnë. Po shoh se këtë umet do ta drejtojnë injorantët dhe të degjeneruarit. Pasurinë e Zotit po e krahasojnë me shtetin, ndërsa besimtarët e Tij po i marrin për robër. Të mirët po luftohen, ndërsa të drejtët po shtypen. Të mjerët ata të cilët këtë përmbysje po e inkurajojnë dhe e ndihmojnë shtrirjen e saj.

Ju betohem se jam me të drejtën, sepse do të dëshmohet për dashurinë time. Në dashtë Zoti, unë do të jem ngadhënjimtar, prandaj edhe ju ngadhënjeni kur përpara jush qëndrojnë veprat, qofshin të lehta ose të rënda. Luftoni me tërë pasurinë dhe vetët tuaja në emër të Allahut, sepse Allahu është me durimtarët. **(Dinuri: 1/ 154-159)**

Përktheu nga arabishtja: Muhamed J. KAJOLLI

1. Aliu r.a. në ditën e parë ishte propozuar si kundërkandidat i Ebu Bekrit r.a. për kalif, nga disa sahabë. Të nesërmen, njeri prej propozuesve të tij u tërhoq, ndërsa Aliu r.a. nuk vonoi dhe ia dha besën.
2. Ka shumë thënie, të cilat vërtetojnë se Omeri r.a. anonte që ta caktonte Aliun për kalif.
3. Për shkak të moshës së tij të re. Aliu r.a. ishte vetëm 33 vjeç kur ndërroi jetë Pejgamberi s.a.v.s.
4. Nëse përemri ata, aludon në kohën e zgjedhjes së kalifit të parë, atëherë Ebu Bekri r.a. ishte 61 vjeç, Omeri r.a. ishte 51 vjeç. Por përemri ata, aludon Osmanin r.a. i cili ishte 68 vjeç kur po zgjidhej kalif. Një grup mendonte se po të zgjidhej Aliu kalif, emevitët nuk do të kishin më shansin ta merrnin këtë post.
5. Edhe pse ndodhën disa vrasje, qëllimi i tyre ishte i mirë. Ata nuk kishin shkuar atje që të përforcoheshin kundër kalifit, por të fitonin ithtarë për t'i shkuar në ndihmë kalifit.
6. Shami, një territor më i madh se sa Ballkani, kishte më pak se njëzet vjet që administrohej nga shteti islam.
7. Në betejën e madhe në Siffin.
8. Mus'hafët ose Kur'anët (Libri i Shenjtë i muslimanëve).
9. Beteja e Nehrevanit.
10. Aliu r.a. sigurisht që do të korrte sukses kundër ushtrisë së Muaviut në betejën e dytë, e cila mendohej të zhvillohej në Siffin. Por, për shkak se havarixhët kishin filluar të vrisnin të pafajshëm, ai, edhe pse kishte marrë rrugën për të luftuar Muaviun, u detyrua të kthehej e t'i luftonte ata. Ndërsa shumica dërmuese e havarixhëve ishin nga prefektura e Irakut. Të dëshpëruar për humbjen e shumë të afërmve të tyre, ushtria e Aliut nuk dëshironte të luftonte më. Ata parapëlqyen kapitullimin përpara secilit grup që do të vinte, por jo të luftonin më midis vete.
11. Fukaha: dijetarë të specializuar në të drejtën islame.

Nili - Burim konfliktesh

Agim AVDIU

Shumë kohë lumi Nil është parë si lumi i shenjtë i Egjiptit dhe tërë Afrikës, që bekonte shtetet të cilat lageshin prej tij. Tani ky lum rrezikon të kthehet në arenë konflikti, me përmasa apokaliptike mes Egjiptit dhe disa vendeve të tjera afrikane, për ndarjen e re të sasisë së ujit. Shtetet të cilat ankohen për dominimin egjiptian të lumit më të gjatë në botë janë Burundi, Ruanda, Tanzania, Uganda, Kongo, Kenia dhe Etiopia. Këto vende pretendojnë për pjesën e tyre të ujit me qëllim të ndërtimit të digave hidroelektrike. Po ashtu, ato duan të furnizojnë terrene të reja bujqësore dhe t'i japin gjallëri atij zhvillimi që ka vonuar të japë frytet e veta pikërisht për shkak të mungesës së ujit. Prej disa dhjetëvjeçarësh, kërkesa për shfrytëzimin e burimeve hidrike çon në përplasje dhe luftëra etnike. Administrimi i ujërave të këtyre lumenjve, për të qenë të gjithë të kënaqur, ka qenë gjithmonë burim problemesh. Por në këtë rast bëhet fjalë për Nilin, që me gjatësinë e tij prej 6700 kilometrash përshkon dhjetë vende, nga Afrika në Mesdhe, duke ndarë në dy pjesë shkretëtirën më të madhe të planetit dhe duke siguruar ushqimin e 300 milionë njerëzve. Traktati deri më tani në fuqi i takon vitit 1929 dhe ishte nënshkruar mes Egjiptit dhe kolonizuesit britanik. Sipas kësaj marrëveshje, parashikohej që Egjipti mund të përdorte 84 % nga 100 miliardë metra kub ujë në vit, që është edhe prurja mesatare e lumit. Në vitin 1959, një protokoll i ri i hartuar mes Egjiptit dhe Sudanit konfirmon atë të vitit 1929 dhe i të dyja vendeve. Ky traktat i detyron vendet e tjera të burimit të informojnë Egjiptin dhe Sudanin për projektet e tyre hidrike. Kjo do të thotë se pjesa tjetër e mbetur prej 1600 miliardë m3 në vit, ose 13%, u mbetet shtatë vendeve të burimit. Në të njëjtën kohë, marrëveshja në fjalë i jep Egjiptit dhe Sudanit të drejtën e përdorimit të vetos për ndërtimin e çfarëdo projekti, i cili mund të ndikojë në pakësimin e sasisë së ujit. Pas një dhjetëvjeçari negociatash të vështira, majin e kaluar, pesë vende që bëjnë pjesë në pellgun e lumit Nil firmosën një marrëveshje të re për shfrytëzimin e përbashkët të lumit, për të ndryshuar traktatin e vjetër kolonial. Pavarësisht bojkotimit të Egjiptit dhe Sudanit, të cilat janë kundër, Etiopia, Uganda, Ruanda, Kenia dhe Tanzania, të bazuar në "Nile Basin initiative", nënshkruan një marrëveshje për ndarjen e re të sasisë së ujit të Nilit. Egjipti dhe Sudani, që janë edhe vendet ku derdhet lumi më i gjatë në botë, janë edhe shfrytëzueset më të mëdha të tij, në bazë të dy marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara në vitet 1929 dhe 1959. Këto dy vende pretendojnë se ato kanë "të drejta historike dhe ligjore" në lumin Nil. Prandaj, prej kohësh ato kanë shpallur të pavlefshme çfarëdo bisedimesh që kanë për qëllim zvogëlimin e sasisë së ujit që ato marrin tashmë. Por, edhe pse shumë vende ishin ankuar për dominim egjiptian të burimeve hidrike të lumit të madh afrikan, nuk ishte arritur kurrë në një marrëveshje të përbashkët. Nga ana tjetër, Kajroja zyrtare ka reaguar menjëherë, duke përfshirë në këtë çështje edhe elemente të sigurisë kombëtare dhe nuk përjashton mundësinë e përdorimit të aviacionit ushtarak kundër Etiopisë, e cila sapo ka nisur ndërtimin e një dige në liqenin Tana Beles, përgjatë rrjedhës së Nilit Blu (me financime që do të vijnë pjesërisht prej qeverisë italiane). Por egjiptianët janë kaq shumë të bezdisur nga planet hidrike të Etiopisë sa kanë nënshkruar një aleancë të re me Eritrenë, armiqtë historikë të Addis Abebas, që në vitin 2006 firmosën një marrëveshje paqeje. Me pak fjalë, nëse nesër Egjipti duhet të sulmojë Etiopinë, ka shumë të ngjarë që përkrah tij të rreshtohen menjëherë edhe trupat e Asmarës. Gjithmonë, sipas Kajros zyrtare, pas kësaj iniciative qëndron Izraeli që po i inkurajon vendet ku buron lumi të kërkojnë të drejtat e tyre, duke u treguar i gatshëm të financojë ndërtimin e dhjetëra digave hidroelektrike. Shtatë vendet e burimit kanë përgatitur 20 projekte të përbashkëta për ndërtimin e hidrocentraleve, për ujitje të sipërfaqeve të reja të tokave. Egjipti dhe Sudani kanë frikë se mund të ndikojnë në pakësimin e sasisë së ujit që u takon atyre. Egjipti mbi 95% të nevojave të tij të ujit i realizon nëpërmjet lumit Nil, ndaj çdo pakësim i sasisë së tij paraqet rrezik për furnizimin e tij me ujë. Sipas gjendjes së tanishme, çdo banor i Egjiptit ka në dispozicion 700 m3, ndërkohë që minimumi i sasisë së caktuar nga Organizata Ndërkombëtare është 1.000 m3. Po kush mund ta zgjidhë këtë problem? Sipas presidentit të "World Peace Foundation", Robert Rotberg, vetëm SHBA-ja është në gjendje të evitojë lindjen e një konflikti për ujin, pasi prej vitesh furnizon me armë si egjiptianët, ashtu edhe etiopasit. "Uashingtoni duhet të ndërhyjë sa më shpejt të jetë e mundur për të qetësuar gjakrat", shkroi pak ditë më parë në "New York Times", Rotberg, duke mbështetur se vetëm administrata Obama është sot në gjendje t'i evitojë rreziqet e një prej luftërave më të tmerrshme në historinë e kontinentit të zi. Egjipti tani duhet të studiojë me shumë kujdes përgjigjen ndaj marrëveshjes që fillimisht e kishte bojkotuar. Kreu i diplomacisë egjiptiane, Ahmed Aboul Gheit, ka shpjeguar së fundmi se po zhvillohen bisedime për të vendosur nëse vendi i tij do të qëndrojë jashtë traktatit, ose nëse do të tentojë ta ndryshojë marrëveshjen, në kuptimin që të jenë të gjithë dakord. Në Egjiptin antik, Nili konsiderohej si rrugë mes jetës dhe vdekjes. Sot ai mbulon 90 për qind të nevojave të vendit për ujë. Nëse Kajro nuk do ta ndajë me vendet e tjera të burimit, për egjiptianët lumi do të shndërrohej në sinonim të thatësirës dhe vdekjes. ■


Lumi Nil

KRIZË IDEOLOGJIKE PO, KRIZË IDEALESH JO!

Rexhep AHMETI

Diçka e madhe që ende është

1. Është diçka që ende na mba(n).
2. E dhe kur nuk e njohim këtë diçka, ajo po na mba(n).
3. Në brendësi, në qetësi te ne, diçka e madhe është, që edhe në këtë krizë të tashme nuk na lë të mposhtemi, të bëhemi të nënshtruar.
4. Diçka e madhe që ende është te shqiptarët, në Republikën e Kosovës, në vitin 2010.
5. Do të ishte marrëzi që t'i dorëzohemi botës së mediokritetit.


Dialektika e kohës sonë

6. Nuk ka më e mençur dhe më e gjithanshme (më pasuri) se koha jonë, përveç kohës që do të vijë pas nesh.
7. Por, ndoshta, edhe nuk do të ketë kohë më të njëanshme (me varfëri) se koha jonë, përveç kohës që do të vijë pas nesh.
8. Kohë e pabesë që nuk të lejon të jesh vetvetja!
9. Kohë në të cilën mund të gjesh e të krijosh besë dhe hapësirë. Por, ne nuk i dimë të gjitha.
10. Kjo kohë, për një kohë tjetër më cilësore.

Vlerat dhe antivlerat

11. Nuk është vlerë të gënjesh sa të mundësh vetëm për të zhvatur sa më shumë, dhe ta arsyetosh këtë me "politikë demokratike pluraliste".
12. Aftësi nuk është nëse i përvetëson, edhe pa lënë gjurmë, paratë e taksapaguesve.
13. Edhe nëse mundesh ta shndërrosh institucionin e Republikës së Kosovës në pronë private, mos i shti mendtë, as mos të të shkojë mendja se je i aftë dhe se do të bëhesh i pasur!
14. Ka te ne doktor shkence që mendon se kyç i shkencës është politika mediokre, që nuk zgjedh mjete për të të bërë të "famshëm" dhe të "pasur"!
15. Titulli a grada shkencore, sot në Kosovë, më shumë është mjet tregu sesa instrument kërkimi, zbulimi dhe thellimi në shkencë.
16. Doktori i shkencës, që e ka blerë doktoratën, pranohet të japë "mësim" në universitete, ndërsa magjistri që ka zbuluar diçka për ta marrë gradën shkencore, nuk i plotëson kushte statusore për të dhënë mësim në universitetet e Republikës së Kosovës!
17. Njeriu i vërtetë, shkencëtari i vërtetë duhet të dijë të japë ndihmesë dhe të jetë shembull se si të dilet nga skëterrat e këtyre "vlerave" që përmenda këtu.
18. Krijimi dhe mbajtja e vlerave, tani në Kosovë, vështirë lejohet dhe krejt pak ndihmohet.
19. Vlerë është edhe mendimi ynë kolektiv që ka ekzistuar dhe na ka paralajmëruar: se më zor është ta mbash, se sa ta fitosh. Kjo vlen edhe për Republikën e Kosovës, tani.
20. Aforizmi i E. Sabatos: Ka kriza ideologjish, por asnjëherë s'ka për të pasur kriza idealesh, duket tepër optimist tash në Kosovë e Shqipëri, por koha e vërteton dhe do ta vërtetojë, përsëri, se është ky mendim, që në esencë, shpreh një të vërtetë të madhe.





Iliriana ALLOQI &
Bernard TAHIRBEGOLLI

PUÇRRAT E RINISË


Akne vulgaris (puçrrat e rinisë) janë sëmundje infektive multifaktoriale të njësisë pilosebaceale që manifestohen me komedone, papulla, pustula dhe noduj. Ato, si një dukuri normale, hetohen gati te çdo njeri në moshën e pubertetit. Aknet shfaqen prej formës gati të pahetueshme deri tek ato shumë të rënda. Kështu që është e vështirë të caktohet kufiri mes gjendjes normale dhe asaj të sëmurë.

Marrë në përgjithësi rreth 15% e popullates kanë akne vulgare. Ato janë ndër sëmundjet më të shpeshta ambulantore. Aknet më së shpeshti shfaqen në moshën e pubërtetit duke ataktuar më se 96% e adoleshentëve. Nganjëherë paraqitja e komeoneve si shenjë e akneve mund të jetë edhe shenjë e parë e pubertetit te femrat. Aknet atakojnë më shumë femrat se sa meshkujt, ndërsa meshkujt i atakojnë në forma më të rënda se femrat.

Zhvillimi i akneve vulgare varet nga shumë faktorë, qofshin ata të jashtëm ose të brendshëm. Prej tyre vlejnë të theksohen: disbalansi hormonal, ndryshimi i sebumit, brirëzimi folikular, mikroorganizmat (Propionibacteriun acne, Staphylococus epidermitis), prirja e trashëguar me reagimin individual të lëkurës, reagim organik ndaj streseve të ndryshme psikike, etj.

Aknet vulgare shfaqen kryesisht në fytyrë, në pjesën e sipërme të shpinës, në parzma dhe në supe. Aknet mund të shoqërohen edhe nga dermatitis seboroik. Zakonisht janë të padhembshme, por në raste të pezmatimeve të thella, atëherë përcillen edhe me ndjenjën subjektive të dhembjes. Për shumë njerëz ato dominojnë deri në moshën 25 vjeçare, ndërsa te disa ato vazhdojnë për shumë kohë dhe, më pas, në dekadën e katërt, zhduken vetvetiu.

Pamja e jashtme jo estetike e akneve ndikon edhe në sferën shpirtërore të të rinjve, duke u manifestuar me ankth, depresion, mos shoqërizim, (në raste ekstreme motive për vetëvrasje), gjë që duhet ta ketë parasysh mjeku gjatë bisedës që e zhvillon me të sëmurin. Pacientit duhet t'i bëhet me dije se shërimi shkon ngadalë e mund të zgjasë deri me muaj e vite. Pra, duhet durim dhe kohë. Moskrijimi i shenjave, i vrajave në fytyrë duhet të jetë qëllimi kryesor për të sëmurin dhe mjekun. Të sëmurët duhet ta kuptojnë që sëmundja vjen e qetësohet me kohë, ndërsa shtrydhja dhe lëndimet e akneve e keqësojnë edhe më shumë gjendjen.



Mjekimi i akneve duhet të fillojë sa më herët dhe nuk duhet të ndërpritet për një kohë të gjatë(1-2 vite). Parimet e mjekimit të akneve orientohen në këto aspekte:

- Të normalizohet rrjedha e sebumit në gjëndrat sebaceale, duke i mundësuar kështu një rrjedhje normale,
- Eradikimi i Probionibacterium acne, përmes aplikimit të antibiotikëve,
- Balansi hormonal,
- Pastrimet antiinflamatore me ujë dhe sapun për të mbajtur kështu sa më higjienike lëkurën,
- Rregullimi i dietës me më pak yndyra dhe karbohidrate.

Ekzistojnë preparate të ndryshme për këto qëllime të lartpërmendura. Një kombinim i këtyre metodave dhe preparateve do të mundësojë një shërim më të lehtë. Sido që të jetë, se cili kombinim i këtyre preparateve do të përdoret tek cili pacient, mbetet të caktohet nga ana e mjekut, duke marrë parasysh seriozitetin e infeksionit, madhësinë, përhapjen, moshën, gjendjen fizike dhe psikike, etj. ■

Deformimi i besimeve fetare në letërsi

Milazim Krasniqi, Letërsia dhe besimet fetare, Logos-A, 2010, f. 310.

Dr. Abdullah HAMITI

Qysh në fillim të librit të Milazim Krasniqit **Letërsia dhe besimet fetare**, ballafaqohemi me qëndrimin e tij si një njeri besimtar, i cili e vë theksin te monoteizmi. Prandaj edhe ai gjuhën e sheh si komunikim të programuar në funksion të adhurimit ndaj Zotit, të njohjes së botës me të cilën jeton dhe si komunikim të ndërgjegjshëm në sferën e vetërealizimit. Dhe pasi kontestonfunksionin dhe rolin social të të folurit dhe të gjuhës, ashtu siç e përshkruajnë disa gjuhëtarë, ai shpjegon se gjuha e ka fillimin në një mjedis josocial, sikundër na e pohojnë librat e shenjtë. Sipas tij: Mjedisi social është i domosdoshëm për individin, për ta realizuar veten me anë të komunikimit gjuhësor, por mjedisi shoqëror krijohet falë aftësive të programuara në vetë njeriun që ta krijojë atë mjedis shoqëror. (f. 29).

Si një njohës i mirë i historisë së religjionit dhe i letërsisë antike e të asaj të mëpastajme, ai e shtron edhe temën e çështjes së komunikimit të njeriut me Krijuesin. Deri tash, te ne, as që është menduar që një intelektual të mendojë për këtë, e lëre më të shkruajë. Natyrisht që edhe sot ka shumë të tillë që nuk mund ta perceptojnë këtë, sepse kjo ka të bëjë me besimin në njëshmërinë e Zotit.

Siç vëren autori, edhe pse në përmbajtje tërësisht të deformuar, këtë komunikim të njeriut me Zotin dhe të Zotit me njeriun, na e ka bërë të njohur edhe vetë letërsia antike greke. Në veprat kryesore të letërsisë antike greke, Iliada, Odiseu, tragjeditë e Eskilit, të Sofokliut e të Euripidit, zhvillohet një komunikim intensiv ndërmjet njerëzve dhe zotave të përfytyrimeve politeiste.

Por M. Krasniqi e di se komunikimi me instancën hyjnore ka ndodhur dhe na përkujton komunikimin e Ademit dhe të Musait me Zotin. Duke e analizuar komunikimin e Agamemnonit me Zeusin (zoti suprem i besimit politeist grek), ai e sheh atë si një ndërlidhje të vagullt të shpalljeve të kohës së Musait me mitologjinë e grekëve të lashtë. Autori nuk lë vend për keqkuptim dhe shprehet se këtë ndërgjegjësim të njeriut për mundësinë e tij që të komunikojë me Zotin, e mundëson besimi fetar, e jo mitologjia.

Mitologjia ka bërë një deformim të madh të besimit fetar, i cili është i lidhur me besimin në Qenie transcendentale, jokonkrete. Konkretizimi i besimit në figura e objekte konkrete, që kanë marrë funksione mistike, është përfytyrim mitologjik për besimin fetar. Kështu, autori shprehet se "Përbërja e besimeve fetare të grekëve antikë është e bashkuar me mitologjinë dhe dominohet prej mitologjisë. Prandaj, ngatërrimi i madh i tyre flet për një shkallë barbarizmi fetar e joemancipimi (f. 26).

Deformimi i shpalljeve hyjnore në letërsinë antike e më gjerë do të trajtohet në vazhdim. Kështu, duke e analizuar formën e komunikimit në veprat antike, veçmas atë të Edipit të Gilgameshit, autori na vërteton se kemi të bëjmë me komunikim të deformuar letrar dhe konstaton: "Ky komunikim me një gjuhë që e ka prejardhjen nga mistika politeiste, çuditërisht është bartur nëpër shekuj dhe jo vetëm ka mbijetuar, por ka arritur ta deformojë ligjërimin artistik të artit letrar deri në kohën tonë (f. 54). Dhe, natyrisht, se kur në ligjërimin poetik mungon komunikimi i drejtë me Krijuesin shkaktohen humbje të komunikimit të drejtë me veten, prandaj edhe sipas autorit të këtij libri "fati i Gilgameshit dhe i gjithë personazheve të artit letrar antik grek e romak dhe i shumicës së personazheve letrare deri në ditët tona, është fati i njeriut të shkëputur nga komunikimi dhe njohja e Krijuesit dhe e komunikimit me veten" (f. 54).



Dhe letërsia do ta ndjekë këtë linjë të depersonalizimit të njeriut nëpër shekuj, për ta bërë atë lajtmotiv të vetin dhe në të nuk kemi komunikim as me Zotin, as me veten. Kështu autori konstaton se "në letërsinë moderne të tipit të romaneve të Kafkës e të Prustit, të dramave të Beketit e të Joneskos dhe të poezisë së Boskesë, kemi një indiferencë të plotë edhe ndaj instancës hyjnore, edhe ndaj vetes, por edhe ndaj të tjerëve" (f. 56).

Duke e analizuar letërsinë antike dhe fetarësinë e saj, M. Krasniqi dëshmon se ato vepra kanë qenë shumë të lidhura me fenë dhe me ritualet fetare. Dhe shton: "Mitologjia antike e ka burimin te religjioni, e jo religjioni te mitologjia. Rrjedhimisht, edhe arti e ka burimin te religjioni antik, që i bie te religjioni politeist, i cili edhe ka qenë punëtoria ku janë sajuar mitet" (f. 71). Dhe kështu, ai e rrëzon tezën se ato vepra gjoja paraqesin edhe fillesën e "poezisë profane", të liruar nga kulti, duke e quajtur atë poezi me elemente të fuqishme fetare, por të një feje që ka qenë politeiste, e cila në kohën tonë trajtohet si mitologji, por që në strukturën dhe në esencën e saj ajo ka qenë fe, besim fetar. Kështu na del se ato vepra të lashta antike duhen vështruar më parë në kontekstin fetar, se në atë estetik.

M. Krasniqi këto konstatime i

mbështet me analiza e krahasime të shumta dhe mandej konstaton: “E habitshme është vetëm se si ajo fe e ngatërruar, politeiste, dhe veprat artistike që e kanë përjetësuar atë, kanë pasur aq fuqi ndikimi mbi fenë e krishterë dhe mbi kulturën e prodhuar mbi botëvështrimin kristian ndër shekuj” (f. 75). Ndërkaq, siç dihet, në letërsinë dhe në filozofinë perëndimore të shekujve të XIX-të e XX-të, më shumë flitet për krizën e identitetit, për fragmentimin e individit, për dyzimin dhe për tjetërsimin e tij. Kjo për arsye se ajo letërsi e ajo filozofi është ushqyer me letërsinë antike greke, e cila kishte bërë deformimin e besimit monoteist, kishte degjeneruar moralin dhe kishte legjitimuar dhunën. Këto tema të dhunës e ato skena të luftës barbare i shpalos e analizon mjaft mirë M. Krasniqi.

Dhe natyrisht, sot, në Perëndim e SHBA, ku në ligjërimin letrar modern kemi njeriun e shkëputur nga Zoti, nga jeta dhe nga bota, ku njeriu për gjithçka është i pafuqishëm dhe i degraduar e i humbur, po lexohet shumë poezia e Rumiut, mistikut të madh islam, e cila u jep shpirt për dashuri hyjnore, që njeriu t'i lutet Zotit e të fitojë kënaqësinë e Tij, pra poezi që grish në besimin tek Zoti dhe në komunikimin me Të.

Në pjesën e parë të këtij libri, autori e trajtoi kështu letërsinë, veçmas atë pjesë të letërsisë evropiane, e cila konsiderohet si kulminante dhe determinuese e vlerave estetike të artit poetik në kulturën perëndimore. Pjesa e dytë e librit, po ashtu, trajton raportin e letërsisë dhe besimit fetar, por tash të letërsisë shqipe dhe fillon me kreun *“Letërsia shqipe dhe manipulimi me “fenë e vjetër” të shqiptarëve”*. Manipulimet e shumta të intelektualëve tanë, që rastisen edhe sot, madje edhe në shtypin e përditshëm, se gjoja shqiptarët që dy mijë vjet janë të krishterë, dhe se shpëtimi i kombit do të bëhet me kthimin në “fenë e vjetër”, pra në krishterizëm, demantohen bindshëm në këtë studim, duke u mbështetur në studimet e dijetarëve të shquar botërorë. Dhe, siç dihet nuk kemi shqipe të shkruar as në antikitet, e as në mesjetë, prandaj edhe autori detyrohet të konstatojë se: “As humanizmi dhe renesanca, si lëvizje kulturore dhe artistike, nuk kanë dhënë asnjë produkt në gjuhën shqipe edhe pse shfaqja e atyre lëvizjeve ka qenë pas sundimit osman mbi shqiptarët. E arsyen pse shqiptarët nuk i preku kjo lëvizje kulturore e humanizmit dhe e



renesancës, autori, e sheh në faktin se ata ishin të integruar në fenë ortodokse dhe në qytetërimin bizantin (f. 201), dhe krejt në fund të elaborimit të kësaj çështjeje, autori i këtij libri fillimin e integrimit të shqiptarëve në lëvizjet evropiane e sheh të ketë ndodhur në periudhën e romantizmit, që ishte një lëvizje artistike e fuqishme laicizuese. Pra, shqiptarët janë integruar me Evropën që nga shekulli i XIX-të e këndej, nga lëvizjet e mëdha politike e artistike, nacionaliste e laiciste, e jo nga klasicizmi (f. 201).

Shqipja filloi të shkruhet tek në shek. XVI e XVII, dhe kjo ishte në thelb letërsi fetare që ishte në kuadër të strategjive imunizuese nga ana e selisë së Vatikanit, kundër reformës protestane dhe përhapjes së Islamit në trojet shqiptare. Sidoqoftë, ato libra kanë vlerë të shënuar gjuhësore, sepse e kanë shenjuar shqipen në një fazë të hershme të ekzistimit të saj dhe i kanë krijuar terren për zhvillimin e mëtejshëm si gjuhë e fesë dhe e kulturës (f. 205).

Siç dihet në fillim të shekullit të XVIII-të zë fill letërsia shqipe me alfabet arab, e cila i përgatit terrenin letërsisë së rilindjes kombëtare. Dhe siç konstaton autori: krijimtarinë letrare në gjuhën shqipe me alfabet arab duhet ta trajtojmë si një dukuri normale kulturore dhe sociale të kohës, e jo me paradigma ideologjike që aplikohen a posteriori, sepse: Sa më shumë që do të zgjatë injorimi i poezisë alamiado, aq më i vështirë do të jetë edhe kompletimi i mozaikut të identitetit tonë letrar, kulturor e kombëtar” (f. 221).

Ndërlidhja e poezisë së rilindjes kombëtare me besimet fetare është mjaft evidente, sidomos te poetët e letërsisë katolike të Shqipërisë së Veriut, që shkruajnë brenda një kuadri biblik, si Pjetër Zarishi, Ndre Mjeda, Anton Xanoni, Gjergj Fishta, etj. Gjithashtu trajtohet edhe botëvështrimi fetar i Naim Frashërit e Fan Nolit, i cili ironizon mjaft “me dukuritë negative” të fesë. Në fund të librit M. Krasniqi vështron realizmin socialist si prodhues i përfytyrimeve ekstreme antifetare në letërsinë shqipe si edhe pseudoestetizmin si prodhues i ateizmit në poezinë shqipe në Kosovë, natyrisht duke sjellë citate nga poezi të autorëve të ndryshëm që shpalosin qëndrimin e tyre absurd ndaj besimit fetar. E të tillë, sigurisht, se ka edhe shumë të tjerë që autori i këtij libri nuk i cek kësaj here.

Me sa mund të shihet në këtë studim të tij mbi letërsinë dhe besimet fetare, e që te ne deri tash nuk ka pasur një qasje të këtillë ndaj krijimeve letrare, Milazim Krasniqi e orienton tehun e tij në demaskimin e vërshimit politeist mbi artet, po edhe në botëvështrimin mbi botën, jetën dhe vetë Zotin si krijues i gjithësisë.

Dhe sa mund të shihet, gjatë gjithë kohës letërsia më shumë ishte e ndikuar nga profania sesa nga hyjnorja, pra duke u devijuar shpalljet hyjnore dhe kështu pjesa dërmuese e produksionit të artit poetik mbetën sfiduese ose mohuese të besimit të vërtetë monoteist. Dhe siç konstaton autori: Megjithatë, një gjë është e qartë përfundimisht: letërsia gjithmonë ka qenë në një raport të caktuar me fenë, herë si mbështetëse, herë si opozitë, herë ironizuese, por gjithmonë e ka si pikë referimi besimin fetar. Edhe kur ajo buron nga politeizmi, edhe kur buron nga ateizmi, edhe kur buron nga agnosticizmi, pikëpamja e saj në të vërtetë është pikëpamje e deformimit ose e mohimit të fesë, që do të thotë sërish është në një raport të caktuar me fenë”(f. 286).

Autori e ka shtruar mirë edhe qëndrimin e Islamit ndaj artit poetik. Ndërsa unë do të shtoja se Islami është fe që e do bukurinë, e vetë Muhamedi a.s. ka deklaruar: “Allahu është i bukur dhe e do bukurinë”.

Arti është një krijimtari e bukur që Islami nuk e kundërshton, por duhet të jetë në parim të njëshmërisë së Zotit, të afirmimit të mësimeve e të udhëzimeve të shpalljeve hyjnore, të respektimit të mesazheve paqësore të pejgamberëve, të të kuptuarit se ekziston edhe bota tjetër. Por, e rëndësishme është se Islami i jep prioritet parimit të moralit ndaj atij të bukurisë, pra, ky është qëndrim parimor islam ndaj të gjitha llojeve të artit, kur arti synon t'i lartësojë emocionet dhe shpirtin e njeriut. Islami e pranon artin nëse ai është i bukur, por nëse ai përmban atë që është e ligë, qoftë material ose moral, Islami nuk pajtohet me të. ■

Nuk është lehtë të jesh balerin në Kosovë

Intervistoi: Flamur MALOKU

Arti, në Kosovën e pasluftës, ka qenë në fund të menysë së çdo qeverie dhe të çdo ministri të kulturës. Prandaj, rrjedhimisht, gjendja dhe pozita e artistit kosovar është keqësuar, ose ka mbetur gjithnjë në nivelin më të ulët të mundshëm, në kuptimin e mbështetjes së tij. Ai detyrohet të mbetet një artist që lufton për ekzistencë. Në këtë mënyrë, të merresh me art në Kosovë do të thotë të bësh një sakrificë të madhe për të arritur diçka. As baleti s'ka mbetur i paprekur nga kjo gjendje e artit. Sido që të jetë, balerinët kosovarë presin dhe shpresojnë për ditë më të mira për ta dhe për artin, në përgjithësi. Ata, si të gjithë artistët e tjerë që i janë përkushtuar misionit të tyre, jetojnë për të bërë art dhe për të qenë gjithnjë misionarë të devotshëm të tij. Artistët nuk kërkojnë një trajtim ekstra special, por një infrastrukturë adekuate dhe një mbështetje më të madhe institucionale.

Për të mësuar më shumë për baletin dhe artin në përgjithësi, për sfidat e shumta që ka baleti në Kosovë, morëm një intervistë të shkurtër nga balerini Sinan Kajtazi, i cili shpalosi për revistën 'Paqja' një pjesë të të qenit balerin në Kosovë.

PAQJA: ***Ju jeni ndër balerinët që jeni paraqitur më së shumti në skenën e baletit. Çfarë do të thotë kjo për ju?***

Kajtazi: Jam balerin i gjeneratës së parë pas lufte, që e kemi përfunduar shkollën e baletit në Prishtinë. Fatmirësisht, gjeneratës sime i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në shfaqjet e trupës së baletit tonë, në të njëjtën kohë që kemi qenë duke u shkolluar për balet. Kjo ka ndikuar shumë mirë te ne, pasi që në moshë të re kemi filluar të paraqitemi para publikut dhe për mua, personalisht, ka pasur rëndësi të madhe. Pasi që kam filluar të luaj në shfaqje, edhe dëshira për t'u marrë me balet më është rritur.

PAQJA: ***A është vështirë të jeni balerin në Kosovë?***

Kajtazi: Jam pjesëtar i një trupe të konsoliduar shumë mirë. Atmosfera në trupën e baletit të bën që ndonjëherë t'i harrosh vështirësitë që ke si balerin, kryesisht ato ekonomike. Jam i vetëdijshëm që unë si balerin, në fillim të karrierës, duhet të fitoj sa më shumë në kohë, pasi që mosha nuk më pret dhe, për këtë arsye, ndoshta problemet që paraqiten i lë mënjanë, megjithëse duhet thënë se profesioni i balerinit, këtu në Kosovë, nuk është i lehtë.

PAQJA: ***Cili ka qenë suksesi juaj më i madh në skenën e baletit?***

Kajtazi: Të gjitha paraqitjet me trupin e baletit kosovar i konsideroj si suksese, në veçanti shfaqjet në këto vitet e fundit, kur kam filluar të marrë përsipër role të rëndësishme. Gjithashtu, e konsideroj si një sukses të veçantë pjesëmarrjen time në shfaqjen "The Raven", në paraqitjen time para publikut në Nju Jork, në teatrin amerikan La Mama Theater.

Njerëzit që punojnë në teatër nuk janë shpërblyer kurrë për punën që bëjnë

PAQJA: ***Baleti si profesion nuk është aq fitimprurës, sidomos këtu në Kosovë. Ju pengon kjo në realizimin e projekteve të tjera jetësore?***

Kajtazi : Realisht njerëzit që punojnë në teatër nuk janë shpërblyer kurrë për punën që bëjnë. Unë baletin e kam profesion dhe e konsideroj të tillë përderisa merrem më të, por gjithashtu studioj muzikën, gjegjësisht, klarinetën. Kohën e kam paksa të limituar, për shkak të orarit të gjatë të ushtrimeve dhe provave, mirëpo dëshira për ta bërë këtë punë me bën që t'i tejkaloj të gjitha këto probleme të vogla.

PAQJA: ***A mendoni se baleti nuk është edhe aq i vizituar nga publiku kosovar?***

Kajtazi: Baleti në Kosovë, fatmirësisht, ka një publik shumë të mirë dhe realisht jemi të kënaqur me publikun që i përcjell shfaqjet tona dhe shfrytëzoj rastin edhe t'i përshëndes. Ne, trupa e baletit, jemi tepër të angazhuar, që të promovojmë sa më shumë vlera te njerëzit. Kjo ndikon që edhe publiku të mos mungojë.



PAQJA: ***Cilat janë projektet e radhës në balet?***

Kajtazi : Sapo kam përfunduar premierën e baletit "Oh, Zoti Im!", me koreografin holandez Arthur Kuggleyen. Këto ditë jam në pushime verore, pas katër premierave të përgatitura njëra pas tjetrës me trupën e baletit. Në shtator do fillojmë premierën e re, me koreografin turk Mehmet Ballkan, një koreograf i njohur në Evropë, i shpallur gjithashtu si koreografi më i mirë në Evropë në vitin 2001. Normalisht që bashkëpunimin me këtë koreograf e çmoj shumë dhe jam i bindur që bashkëpunimet e tilla do ta rrisin reputacionin e baletit kosovar.

PAQJA: ***Një mesazh për fund?***

Kajtazi: Kisha dashur që të përcillja një mesazh, sidomos tek të rinjtë, pasi që edhe vetë jam në moshë të re. Kushtojini sa me shumë kohë shkollimit tuaj dhe merruni me gjëra që ja vlen dhe me gjëra që ju sjellin një të ardhme të ndritshme. ■

Mbi estetikën e një shfaqjeje

Imer TOPANICA

Loja / Jetësimi

Arti është një oqean i pafund. Ka njerëz që e shohin ëndërr, vetëm ëndërr, ka që u ka rastisur të kalojnë pranë tij kalimthi, ka që janë lagur nga stërkalat e tij, ka që kanë notuar me mjete mbi të, ka që kanë qenë notarë të mirë, por ka dhe oqeanistë, njerëz që me ngjyrën e lëkurës, të syve, të duarve dhe me anën e zemrës i kanë ngjarë peshkut (shpirtit të oqeanit) dhe që janë të zotë të notojnë nëpër këtë ujësi me një zotësi absurde... Por, këta të fundit janë të rrallë. Prandaj historia e tyre mbahet mend lehtë. Pra, mund të pajtohemi që brenda artit ka po aq rrugë sa ka edhe brenda oqeanit tonë imagjinar. Nëse dikush nga këta mjeshtër të notit, e ka zbuluar stilin e bretkosës, pas tij ka ardhur një tjetër që e ka zbuluar një stil tjetër, po e zëmë atë në shpinë dhe secili prej këtyre krijuesve/ zbuluesve/shpikësve, ka ndërtuar stilin e tij, duke e kundërshtuar tjetrin. Sepse oqeani (arti) i ka duruar dhe i duron këto lloj diversitete të stileve, të vulave të origjinalitetit krijues. Sido që të jetë, ai që mendon që e ka prekur fundin e oqeanit është një hiç i madh, një kufomë. Homeri, Rumi, Khajami,Sofokliu, Gëte, Hygoi , Ibsen, Becket e shumë të tjerë, s'janë veç se disa gjeni që kanë fascinuar të tjerët me guximin dhe shkathtësitë e tyre për të notuar në thellësitë e këtij oqeani, por kurrë nuk është bërë një matje e saktë se sa ka qenë rekordi i thellësisë së tyre. Ky është kuptimi i nocionit të lojës në thellësinë e artit, të cilën e prekim dhe e shijojmë shpesh, por intensiteti i kësaj shijeje ndryshon gjithsesi.

Loja e një drame

Një përkujtim në kafe & teatër ndërtohet mbi filozofinë e një dyfishi, dyfish i kodifikuar dhe i shkrirë brenda dy personazheve, si dy jetë brenda botës së dramës (Aurelit dhe Albanit). Dikotomitë e tjera zbërthehen përmes dialogut të po këtyre dy karaktereve, mjaft tipike brenda kësaj drame. Dialogu prek/ zbulon dhe portretizon karakteret, duke prekur toponiminë e dyfishtë të një rruge në poliseminë e saj praktike (Aleksandër Moisiu), numrin dy të akteve seksuale dhe numrin dy të objekteve (televizorëve) të njërit prej karaktereve (Aurelit) dhe disa dyfishe të tjera brenda skenës, që shpesh, në parim, duken nuanca të pavërejtura. (Në vend që të lyejë me ngjyrë tavanin e skenës, i hipur mbi shkallë, Aureli nxjerr borë nga kova dhe e hedh mbi Albanin, duke prishur iluzionin e shikuesit, iluzionin e të mundshmes së gabuar të një lexuesi/ shikuesi). Loja me këtë numër, nga dramaturgu Mulliqi, është një lojë që prodhon figurën dhe një gjuhë konotuese që e kërkon arti. Figurabiliteti i tillë i ndërtuar mbi këtë dyfish jep ose prodhon shpesh metaforën skenike, ironinë dhe sarkazmin. Ironia dhe sarkazma janë dy tehe të shpatës/ armës së mjeshtrit të dramaturgjisë, armë me të cilat ai e materializon idenë e dramës.

REALIZIMI i personazheve dhe jetësimi i tyre në skenë bëhet mjeshtërisht nga dy aktorët e përzgjedhur nga regjisori Mulliqi e që janë: Mentor Zymberaj dhe Ismet Azemi. Shfaqja u dha edhe në fund të Festivalit Ambiental Teatror, Teatri Ndryshe, në një ambient të hapur, pranë Liqenit të Batllavës, domethënë ndryshe nga skena e zakonshme. Kjo gjë krijoi mundësi shumë më të mira për akustikën, një element jo pak i rëndësishëm për natyrën e skenës teatrore. Performanca e aktorëve në fjalë ishte mbi nivelin e zakonshëm, falë këtyre kushteve të pazakonshme skenike.

Drejt një interpretimi

Ajo që të provokon në këtë shfaqje është loja e dyfishtë me idenë e zhbërjes së individit, vdekjen e ngadaltë të personalitetit dhe dehumanizimin e tij. Ky është rrafshi mbi të cilin ndërtohet ideja e zhbërjes së qenies humane dhe kuptime të tjera e ide të reja më pak të qëndrueshme. Them e dyfishtë sepse ka dy rrafshe ideore që hahen njëra me tjetrën për të dhënë këtë ide. Secilit rrafsh i korrespondon njëri nga personazhet. Po e zëmë Albani, një ish-ushtar dhe patriot, pjesëmarrës në disa luftëra, përfaqëson rrafshin e zhgënjimit total deri në skajshmëri, deri në tragjike. Dhe kjo anë, ky rrafsh e çon interpretimin deri te versioni i tragjedisë me nuanca të komikes (humorit të zi). Rrafshi tjetër korrespondon me Aurelin, respektivisht një aktor i dështuar, që është sinonim i humorit të zi, në një shkallë më të butë, më elastike dhe që shkon drejt tragjikomedisë , respektivisht zhanrit të komedisë së zezë. Tashmë mund të thoni se tragjedia me nuanca komike, tragjikomedia dhe komedia e zezë është i njëjti nocion kuptimor. Por kërkimi në rrafshin semantik, brenda dialogëve dhe veprimeve në skenë, çon drejt këtyre versioneve, megjithatë jo aq të ngjashme:
a) - Karakteri i Albanit dhe fati i tij tragjik - drejt tragjedisë dhe; b) - Karakteri i Aurelit dhe fati i tij tragjiko-komik drejt – tragjikomedisë.

Në rrafshin tematik, drama prek shumë çështje. Çështjen e devalvimit të heroit, mosrespektimin e një ish-ushtari, temën e mosrealizimit të dëshirave dhe ëndrrave të një njeriu që do të bëhet aktor, temën e përçmimit dhe harresës kolektive, në kuptimin ndaj vlerave artistike (në rastin e emrit Aleksandër Moisiut). Ndërkaq, nëntema dhe motive të tjera janë shtresuar mjeshtërisht nëpër tekstin e dialogëve, duke bërë që drama të notojë bindshëm në ujërat e pafundme të oqeanit artistik. Realiteti i literarizuar dhe i vënë në skenë jep konotativisht vlera universale.

Ideja e zhbërjes së artistit dhe luftëtarit, dy nga personifikimet më të afërta dhe më simbolike të shpirtit të atdheut, prodhon idenë qendrore, e cila është: fati tragjik i një kombi. I gjithë ky sistem idesh, që mund të zbulohet vetëm përmes gjuhës së figurës, duke kuptuar secilën nga këto shenja, prodhon idenë e parë, pas së cilës fshihet e dyta, deri tek ideja qendrore: flasin për 'hilen' mjeshtërore të një artisti të guximshëm, i cili është pjekur brenda revoltës ndaj padrejtësisë.

Përfundim / Evokim

Vetë titulli "Një përkujtim në kafe & teatër" zbulon një fuqi variantesh semantike të shpërndara në dyshe. Teatri, si sinonim i kulturës, qytetërimit, fisnikërimit të ndjenjave dhe kafeneja – antipodi i këtij kuptimi. Por kjo botë dramatike e Mulliqit nuk do ta kishte këtë fuqi sikur të mos jetësohej me mjeshtri nga dy aktorët e mrekullueshëm: Mentor Zymberaj dhe Ismet Azemi. Ndoshta vepra e tillë pati një amplitudë të tillë estetike falë ambientit të hapur, të cilin nuk e kishte provuar më parë. Loja e tillë, ishte një kurorë e bukur e mbylljes së Festivalit Ambiental Teatror, Teatri ndryshe që u mbyll para pak ditësh, i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Podujevës, nën patronatin e kryetarit të kësaj komune. ■



EDHE NJË JUNIKAS KAMPION I BOKSIT NË GJERMANI

Haxhi Krasniqi, pas 10 rundeve, mposhti me pikë rumunin Tomi Dima. Ishte ky titulli i parë në karrierën e tij si boksier, në kategorinë gjysmë të rëndë GBO internacional

Alban BILALLI

Pas Luan Krasniqit, një tjetër djalosh nga Juniku po lë gjurmë në ringjet e boksit në Gjermani. Boksieri Haxhi Krasniqi, në muajin qershor, fitoi titullin e kampionit në kategorinë gjysmë të rëndë GBO internacional. Haxhiu, pas 10 rundeve, mposhti me pikë rumunin Tomi Dima. Ishte ky titulli i parë në karrierën e tij si boksier, ngase ai më parë merrej me sportin e karatesë dhe ishte shpallur kampion në Kosovë. Haxhiu e vlerëson këtë titull si shumë të rëndësishëm dhe shpreh synimet e tij për ta fituar edhe titullin e botës. *"Ky titull është shumë i rëndësishëm për mua, sepse synimet e mia janë që të fitoj titullin e botës"*, - është shprehur Haxhi Krasniqi, ditë më parë në ueb faqen e tij. Haxhi Krasniqi, ndonëse është 23-vjeçar, deri më tani ka një bilanc prej 31 fitoresh, nga gjithsej 33 duele sa ka zhvilluar deri më tash.

Haxhi Krasniqi është i lindur në Junik, më 5 shtator të vitit 1987. Është kushëri i Luan Krasniqit.

Haxhiu, deri në moshën 17-vjeçare, jetoi në Junik. Atje Krasniqi ishte i angazhuar në karate, ku u bë edhe kampion i Kosovës. Në fundin e vitit 2004, shkoi në München të Gjermanisë. Aty vendosi të vazhdojë boksin, pasi që në karate arriti shumë sukses. Pa humbur shumë kohë e vizitoi klubin Boxfabrik në München dhe duke u stërvitur me profesionistët, trajnerët e klubit e hetuan talentin e tij dhe i dhanë mundësinë që të boksojë menjëherë si profesionist.



Më 20.10.2005 zhvilloi ndeshjen e parë dhe, në një kohë të shkurtër, bëri 12 ndeshje, 10 prej të cilave i fitoi. Menaxheri Suttner, prej vitit 2007, ia bëri të mundur që të ndeshet disa herë në parameçe të vëllezërve Klitschko dhe kështu u afirmua Haxhiu si 19-vjeçar profesionist, çka është jo e natyrshme për këtë sport. Haxhiu që nga nëntori i vitit 2006 është i pamposhtur.

Më 07.07.2007 Krasniqi luftoi kundër amerikanit Berry Butler, i cili në atë kohë kishte një rekord prej 45 ndeshjesh dhe një moshë shumë më të pjekur se kosovari, Haxhi Krasniqi. Duelin ndaj tij, Krasniqi e fitoi me poenë, para 20.000 shikuesve në Cologne Arena të Gjermanisë, ku më pas u përballën edhe kampioni i peshave të rënda Wladimir Klitschko me amerikanin Lamon Brewster. ■

PAS PARAQITJES NË "AFRIKA E JUGUT 2010" VIJNË OFERTAT PËR SHAQIRIN



Dilaver POLISI

Mesfushori kosovar, Xherdan Shaqiri, është ndarë i kënaqur me paraqitjen e tij në kampionatin botëror "Afrika e Jugut 2010" me përfaqësuesen e Zvicrës, edhe pse luajti vetëm 11 minuta kundër Hondurasit. Ai u aktivizua në minutën e 79-të, në ndeshjen ku "helvetikët" barazuan pa gola. Shaqiri ka zhvilluar katër ndeshje për Zvicrën, duke përfshirë edhe ndeshjet përgatitore para kampionatit botëror.

Shaqiri u shpall lojtari më i mirë i ri i edicionit 2009/2010 të Superligës zvicerane, i cili vlerësohet ndër futbollistët më të talentuar në Zvicër. Ai ka luajtur në 19 nga 22 ndeshjet e edicionit 2009/2010 të Superligës së Zvicrës. Ka realizuar një gol e dy asistime. Në nëntor të vitit të kaluar luajti dy ndeshje për U-21 të Zvicrës, ndërsa më herët ishte pjesë e përfaqësueseve të grupmoshave më të reja.

Shaqiri, në dy ndeshjet e para të stinorit pranveror të Superligës së Zvicrës, ishte titullar te Baseli, në pozitën e mesfushorit të krahut të majtë.

"Jam ndarë i kënaqur që kisha rastin të paraqitem disa minuta me Zvicrën në një kompeticion kaq të rëndësishëm siç është Kampionati Botëror. Ishte një aventurë e re për mua. Gjithashtu kam marrë edhe lëvdata pas ndeshjes nga trajneri Ottmar Hitzfeld. Jam ende i ri dhe besoj se do të arrij të luaj tërë ndeshjen", - ka thënë Shaqiri.

18-vjeçari Shaqiri është anëtar i klubit zviceran Basel, me të cilin ka kontratë deri në qershor të vitit 2014. Ai, në verë të vitit të kaluar, iu bashkua Baselit nga skuadra e të rinjve të këtij klubi, kurse në pranverë arriti të zërë vend në ekipin e parë dhe, njëherësh, e ndihmoi këtë skuadër që të fitonte titullin e kampionit dhe trofeun e Kupës së Zvicrës. Ai ka folur edhe për dy futbollistët kosovarë që luajtën për Zvicrën në këtë kampionat, mesfushorin Valon Behrami e Albert Bunjaku.

"Me të vërtetë më vjen keq se si i ndodhi Valonit të marrë karton të kuq. Ai nuk e meritoi aspak të merrte kartonin e kuq. Ai është një profesionist dhe nuk bën gabime të tilla. Ndërsa Alberti është një sulmues i spikatur dhe është një sulmues jashtëzakonisht i mirë. Mendoj se Alberti e ka merituar të luante që nga minuta e parë kundër Hundorasit, por ai nuk u aktivizua fare dhe mendoj se do të ishte dashur të luante", - ka shtuar Shaqiri.

"Ndihem i lumtur që arritëm të shpallemi kampion i Zvicrës, si dhe të fitojmë Kupën e Zvicrës. Për mua ka vlerë vetëm suksesi i klubit, e jo suksesi individual, sepse ne, së bashku, e kemi fituar titullin. Unë gjithmonë mundohem ta bëj më të mirën për klubin, e nëse arrin ta ndihmosh klubin vjen edhe shpërblimi i merituar. Në këtë rast ishte ftesa që më erdhi nga trajneri i Zvicrës për kampionatin botëror", - ka thënë Shaqiri.

Për shërbimet e mesfushorit gjilanas, Xherdan Shaqiri, kanë shprehur interesim shumë skuadra nga ligat më të forta evropiane. Ai thotë se ende nuk ka vendosur se në cilën skuadër do të kalojë, por ai dëshiron të luajë dhe të formohet ende si lojtar. Sipas tij, oferta ka pasur nga klube të mëdha nga Gjermania, Italia e Anglia.

"Jam i ri dhe kam luajtur rregullisht për Baselin në kampionatin që fituam. Kjo bën që klubet e mëdha evropiane të jenë të interesuara. Për mua aktualisht janë duke u interesuar klube të forta të Gjermanisë, Italisë dhe Anglisë. Ende nuk e di se kur do te largohem, por synimi im është që një ditë të luaj në ndonjërën nga ligat më të forta evropiane", - ka thënë Shaqiri.

Pjese e skuadrës seniore të Baselit janë edhe mbrojtësi Beg Ferati dhe mesfushorët Taulant e Granit Xhaka. Ferati ka luajtur herë pas here, ndërsa vëllezërit Xhaka janë në pritje të debutimit. Ata, muajin e kaluar, kaluan nga ekipi i të rinjve në atë senior.

"Është kënaqësi kur ke në skuadër edhe tre futbollistë shqiptarë, pasi ndihesh edhe më i fuqishëm. Të tre futbollistët janë të shkëlqyer dhe janë jashtëzakonisht të talentuar. Besoj se stinorin e ardhshëm do t'u jepet rasti edhe dy vëllezërve Xhaka", - ka thënë Shaqiri. ■